REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 31.10.2025 Prot.45 (dyzetëepesë)

Protokoll nr. 45

I mbajtur sot më datë 31.10.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.08.2025 dhe 15.09.2025.
4.Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë Këshillit Bashkiak Maliq *"Mbi dhënien e mandatit të këshilltarit z.Selami Muço"* pas vakancës të krijuar.
5. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2025";
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
7.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.V.A banues në Maliq dhe znj.D.Z banuese në fshatin Strelcë NJ.A Gorë, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
8.P-V "Për detajim fondi sipas aktit normativ datë 08.10.2025'';
9.P-V " Për konfirmimin e inventarizmit në mënyrë të gabuar të pasurive nr.109/47, z.k.2984, fshati Plasë, në listën e inventarit të proneve të transferuara me VKM nr.1154, datë 13.08.2028 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pojan, të Qarkut të Korçës*";
10.P-V "Për miratimin në parim, të zhvendosjes së lapidarit përkujtimor të të rëneve të luftës, që ndodhet në pasurinë nr.778, z.k.2445, fshati Libonik, NJ.A Libonik, në vendodhjen e re, në pasurinë nr.114/80, z.k.2445, fshati Libonik NJ.A Libonik";
11.P-V "Për miratimin në parim të një ndryshimi në sistemin *"ALFIS"* të ekonomisë pyjore Mesmal";
12.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Ornildi Demollari; Gentiana Drabo; Xhuana Hoxhallari; Aramando Dautllari; Petrit Kupe; Dritan Çami; Idlir Limllari; Danjela Ibrahim; Marinathi Avrami; Enida Avdolli; Klea Baçi; Floreta Zaçe; Pranvera Begolli; Selami Muço; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Neresida Shindo; Server Xhuti; Dalina Krekas; 21 (njëzetëenjë) këshilltarë

Mungesa: Eriseld Jonusllari; Fevri Sherifi; Kristina Malelli; Rovena Terolli; Ilia Xhuti; Plator Çollaku; Marjeta Xhelollari; Andonaq Risto; Almir Elezi; Albina Xhejo; 10 (dhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjësi i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta.

Ornildi Demollari: Mirë, ju lutem, fillojmë përshëndetje të gjithëve, të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës. Fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë, sikurse jeni njoftuar disa ditë përpara, sipas afatit që përcakton ligji, ku jeni njohur edhe me materialet, besoj. Kështu që mund të vijojmë. Si fillimisht, verifikojmë korumin. Besoj, korumi realizohet pasi janë sipas listës prezencës, janë diku te njëzetë këshilltarë në sallë, kështu që mund të vijojmë, përsa nuk kushtëzohemi dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, por dua të ndalem pak tek pjesa që dje së fundmi na kanë erdhur tre materiale të tjera, të cilat Ekzekutivi kërkon që t'i shtojmë në rendin e ditës. Janë dy materiale për kostume, kostume sportive dhe kostume artistike dhe një material që e ka sjellë zyra e urbanistikës për një inventarizim, në mos gaboj apo jo, Andi.

Petrit Kupe: Me leje, po. Desha të thosha kështu, paraprakisht, të propozojmë për një minutë heshtje për viktimat që na kanë ndodhur në qytetin Maliq.

Ornildi Demollari: Po, shumë e drejtë. Shumë e ditë, atëherë ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje.

Pranvera Begolli: Kryetar kishte dhënë diçka para se të jemi te rendi i ditës. Aktualisht, javën e parë ne bëmë një trajnim me këshilltarët nga një subjekt dhe nuk më vjen mirë që këshilltarët tona, sidomos të vajzat e reja që do jenë në perspektivë, nuk ndodhen nëpër këto trajnime. Ato janë trajnime me vlera, që thjesht mos jemi ngritëse kartoni, po të dimë të të drejtat që ne kemi për këtë karton që kemi këtu. Më erdhi mirë që Pogradeci i kishte të gjitha këshilltarët, të majta e të djathta, dhe Korça vetëm Maliqi ishte e përfaqësuar nga dy unë dhe Lola. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Tani të jesh të qenit anëtar i Këshillit Bashkiak ka dhe disa angazhime të cilat janë tërësisht individuale, por megjithatë e shikoj me vend thirrjen tënde. Faleminderit. Atëherë, tek rendi i ditës, a jemi dakord duke shtuar edhe këto tre materiale?

Faslli Zholi: Përshëndetje të gjithëve, përsa i përket renditjes për këto dy pikat që po diskutohet. Neve e morëm me vonesë dhe unë e shkruaj datën në kryesi që është në kundërshtim me këtë.

Megjithatë, janë këto veshjet. Unë e quaj që të mos ndodhi më kjo që të zvarritet, se ne tashi po i shikojmë gjërat dhe të mos bëhet e udhës kjo. Sepse shkelim dhe rregulluam shkeljen e ligjit. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Po shumë e drejtë, atëherë e kalojmë votim duke miratojmë rendin e ditës, duke shtuar tre materialet që sollëm me vonesë.
Kush është dakord? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka. Miratohet.rendi i ditës. Faleminderit. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, ku janë gjithsej. Tre vendime me karakter normativ, të cilat janë konfirmuar nga institucioni i prefekturës, dhe katër me karakter kolektiv janë gjithsej. Shtatë vendime, ndërkohë janë dy të cilat nuk janë konfirmuar nga institucioni i prefekturës. Është vendimi me numër njëqind e katërmbëdhjetë dhe vendimi me numër njëqind e pesëmbëdhjetë. Janë vendime të zyrës së emergjencave dhe do të ftojë zotërinë përfaqësuese Stiljan. Si është puna me këto? Atë që nuk e ka konfirmuar Prefekti/

Përgjegjësi i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta:Përshëndetje të gjithëve, atëherë kemi rastin e një akti për dhënie ndihme financiare familjes së dëmtuara si pasojë e rënies së zjarrit. E cila ka ndodhur në muajin korrik është miratuar akti dhe në mbledhjen e kaluar është miratuar akti nga Këshilli i Bashkisë dhe sipas procedurës që ka institucioni i prefektit të qarkut të Korçës për të garantuar ligjshmërinë e aktit. Nga ana e tyre ka erdhur një përgjigje, e cila nuk miraton, pra ose nuk shpall mosvlefshmërinë e aktit në fjalë. Sipas pretendimit të tyre, këtu është dhe thelbi i problemit. Nga ana e Bashkisë Maliq, duhet të pasqyrohej një relacion përmbledhës. I cili të sqaronte përmes këtij relacioni objektivat, synimet apo qëllimet që duhet të arrihen përmes këtij akti. Çfarë ndodh? Këtë duhet t'ia sqaroj edhe këshillit të bashkisë. Pajisja me një relacion përmbledhës nga ana e këshillit, nga ana e sektorit të emergjencave civile, pra e bashkisë me ligj të këtij akti, sipas pretendimit të tyre bazohet në ligjin njëqind e shtatë dy mijë e gjashtëmbëdhjetë neni gjashtëmbëdhjetë pika dy për prefektin e qarkut të ndryshuar. Referuar këtij ligji, referuar këtij ligji nga ana e bashkisë, kundërshtohet sepse. Ne domethënë ligji qind e shtatë dy mijë e gjashtëmbëdhjetë neni gjashtëmbëdhjetë pika dy sqaron se, projektvendimet apo aktet e tjera normative që nxirren nga institucioni i prefektit të qarkut Korçë, duhet të pasqyrohen me një relacion përmbledhës. Pra, relacioni i përmbledhës është një normë ose është një akt që duhet të nxirret ose duhet të prodhohet nga institucioni i prefektit të qarkut të Korçës. për qëllimet apo për interesat e tyre, ndërsa aktet, normat ose standardi i përgatitjes së relacioneve nga ana e institucionit të qeverisjes vendore. Në rastin konkret, bashkia Maliq. Miratohen miratohen nga këshilli i bashkisë referuar nenit pesëdhjetë e katër të ligjit njëqind e tridhjetë e nëntë dy mijë e pesëmbëdhjetë për vetëqeverisjen vendore. Ku citon, mund të hapni edhe ligjin në qoftë se dëshironi. Citon gërmë për gërmë, që të. Këshilli i Bashkisë është organi i vetëqeverisjes vendore dhe në nenin pesëdhjetë e katër dhe miraton normat, miraton kriteret, miraton procedurat, miraton relacionet. Që i duhen bashkisë ose që do të përdoren bashkisë për të rregulluar funksionet e saj në shërbim të interesave të përgjithshme të qytetarëve. Pasi kemi kundërshtuar dhe gjetjet, njëkohësisht jemi i rekorduar edhe me

institucionin e prefektit të qarkut dhe kemi rënë dakord që me shpjegimet përkatësve, ta rifutim dhe një herë këtë akt për rishqytim dhe normalisht që do të marri edhe konfirmimin e tyre.

Ornildi Demollari: Atëherë, kjo ishte fjala për vendimin njëqind e katërmbëdhjetë që e kemi pasur në mbledhjen e së kaluar dhe për shkak se prefektura ka kërkuar një shtesë në tek relacioni, e kemi në këtë mbledhje për ta rimiratuar dhe vendimi me numër njëqind e pesëmbëdhjetë, tek i cili prefektura. E ka kthyer me shpjegimin që mund të, nuk ka nevojë të shkonte në prefekturë, pasi me urdhërin e kryetarit mund të, mund të kalojë. Kështu që, tek kjo jemi. Të lutem, ulu të mbarojmë pastaj në fund, në fund, në rregull, mirë. Atëherë ecim me rendin e ditës, po.

Yllson Ibrahimllari:Është në emrin tim personal dhe të këshilltarëve të Gorës në këtë këshillë bashkiak. Propozoj një minutë heshtje për. Largimin nga kjo botë te Doktor Ahmet Hoxhallarit, qytetarit të nderit të Bashkisë Maliq. Ju lutem këshilltarëve të ngrihen këmbë. I paharruar qoftë kujtimi i përjetshëm, kujtimi i Doktor Ahmetit.

Ornildi Demollari: Sipas rendit të ditës, ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së datës 26 gusht. Kush është dakord me protokollin e mbledhjes datës 26 gusht? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka. Faleminderit. Ju ftoj të miratojnë protokollin e mbledhjes së datës 15 shtator. Është një mbledhje jashtë radhit që kemi zhvilluar në shtator. Kush është dakord me protokollin e mbledhjes? 20 vota pra.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka. Faleminderit. Miratohet edhe protokolli i mbledhjes sipas rendit të ditës. Jemi tek miratimi i raportit të hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë Këshillit Bashkiak Maliq mbi dhënien e mandatit të këshilltarit të Zotit Selami Muço, pas vakancës së krijuar, ftoi komisionin të lexojë raportin. Po.

Pranvera Begolli: Përshëndetje, përshëndetje kolegë. Aktualisht, komisioni i mandateve dhe i ligjeve u mblodh sot dhe ka një raport dhënie mandati për këshilltarin që zëvendëson këshilltarin që u largua në zbatim të ligjit numër 139, dy mijë e pesëmbëdhjetë, datë 17.12. 2015. Përvetë qeverisjen vendore, i ndryshuar neni dyzetë e nëntë, mandati i këshilltarit pika një dhe dy, neni pesëdhjetë e katër, detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, gërma j dhe në zbatim të rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq, miratuar me vendim Këshilli numër njëzet e katër, datë dymbëdhjetë i treti dy mijë e njëzetë, për miratimin e rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq neni njëqind e shtatëdhjetë e dy. Marrëdhëniet e Këshillit me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe duke i bazuar në shkresën me numër gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre, protokoll datë njëzet e tre i nënti dy mijë e njëzet e pesë, të komisionerit shtetëror të zgjedhjeve, njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënie mandati protokolluar pranë Bashkisë Maliq. në datën njëzet e pesë të nëntë të dy mijë e njëzet e pesë, si dhe vendimi numër një mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Tiranë, datë nëntë të vitit dy mijë e njëzet e pesë, për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Maliq, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë. Zotit Selami Axhi Muço, dalë nga zgjedhjet për qeverisjen

vendore të datës katërmbëdhjetë maj dy mijë e njëzetë e tre. Nga verifikimet e dokumentacionit, komisioni vërtetoi se mandati është fituar konform kërkesave të Kodit Zgjedhor. Dhe ligjit 139, 2015, përveç qeverisjes vendore, i ndryshuar, ndaj i propozojmë Këshillit Bashkiak. Miratimin e raportit për dhënien e mandatit të këshilltarit të Zotit Selami Haxhi Muço, kandidat në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, përgatitur nga Komisioni i Mandateve. Sekretari i Këshillit të Procedurës, kryetar, të kryhet formula e betimit. Ju faleminderit

Ornildi Demollari: Atëherë, po faleminderit, e kalojmë në votim raportin e komisionit të mandateve në fillim. Kush është dakord me raportin? 20 vota pro.
Kundër nuk ka
abstenim, nuk ka faleminderit. Atëherë ecim sipas procedurës me formulën e betimit. Zoti Selami, ngrihu në kamp, të lutem. Atëherë, teksti i betimit, betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Maliq dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.
Selami Muço:Betohem,
Ornildi Demollari: Faleminderit, suksese, suksese, faleminderit të gjithëve. Atëherë kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fonditë për muajin shtator dy mijë e njëzet e pesë.mbledhjes I bashkohet dhe Këshilltari z.Selami Muço, shkon në 21 numri i Këshilltarve të pranishëm në sallë. Komisioni po.

Faslli Zholi: Tashti përsa i përket, unë do themja dy gjëra për miratimin e ndihmave ekonomike, gjashtë për qind. Do flas, s'ka si të flas ndryshe ne si këshilltar në emrin tim personal, se ne kërkojmë gjithmonë edhe që të mblidhet komisioni. Komisionit nuk mblidhen. Dhe dije konkretisht, nuk pati përveçse unë, Gerti dhe vajza që komunikuam me, që është për ndihmat ekonomike. Desha të shtoj një këtu që këto komisionet i kam thënë dhe po i them hera herës dikush dhe vajza më tha që e dinte se ishte në komisionin. Janë të ndryshuar. Që nuk më lënë, nuk ua shoh këto punë kryetarëve. Unë di që edhe rregullorja kemi detyrim ligjor që komisioni, kur lihet, qoftë ditën e mbledhjes, qoftë ditën e parë, siç është edhe e shkruar edhe me ligj e me rregullor. Këshilltari, besoj, duhet të tregojë figurë. E kam thënë edhe disa herë të tjera para qytetarëve që e kanë zgjedhur. Dhe ka detyrime të vijë në komision. Nuk ka institucion, me ç'di unë, që ta pengojë, qoftë privat, qoftë shtetëror, këshilltarin, që të mos vijë në mbledhjen e komisionit apo në mbledhjen e këshillit. Në qoftë se e gjen dikush dhe ka pengesa, kjo zgjidhet me shkresa nga ana e këshillit. Këtë e kam bërë disa herë dhe do ngulmoj ta kërkoj që komisionet duhet të mblidhen dhe të bëjnë punën. Ashtu siç e kërkon rregullorët dhe ligji, përsa i përket ndihmave të ekonomike, unë i pashë ato. Dhe Ermanda ka vend aty të shikoni dhe t'u kërkosh përgjegjësi dhe kërkesë llogarie ndaj administratorëve, që kur përpilojnë këto. Hallexhinj janë të gjithë, shikoj ka familje aty që mos merrem me emra, se s'dua të thashë kështu. Është i vetëm pensionist, merr dhe një ndihmë ekonomike, ose janë dy veta, të dy në pension. Ne kemi familje, mendoj unë, që ju i dini, ne i dimë. Që janë tre katër veta në shtëpi,

nuk kanë as pension dhe nuk marrin ndihma. Tani ja kam bërë, as kam bërë kërkesë. Këtë nuk jam që t'ia them kompentent. Prandaj ka vend për ta përmirësuar këtë, ato pak leka që marrin, se nuk është ndonjë tarifë e madhe, po, e vlerësojmë edhe atë si gjithë të tjerët që kanë edhe në këtë histori, prandaj duhet të ngulohesh më shumë në ish-Komunat që kur të përpilojnë këto kërkesa të qytetarëve të kenë kujdes, mos marri dikush që është më mirë se x dhe mos marri ai që është më keq se tjetri.Edhe jam dakord që ta miratojmë që ndihmat shkojnë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, po.

Yllson Ibrahimllari:Për kryetar të nderuar kolegë, është e disa herë që vijmë dhe bëjmë gjerësi fjalie, duke na nisur sërish të njëjta gjë që unë duhet të jem konçize dhe ju duhet të jeni tallakatur. Përveçse nga kjo mbledhje në dhe mbledhjet në vazhdim, presupozohet Fazlliu, që bëri një ekspozetë të gjerë, t'i drejtohet këshillit. Komisionet, siç kemi vendosur, do mblidhen një ditë përpara, jo dhe jo te kafja e mëngjesit përpara mbledhjes së këshillit dhe raporti që ne do na paraqitet. Kur flet kryetari, do t'i paraqitet të dyja grupeve respektive në këshillin bashkiak.Relacioni i komisionit. Siç vjen ekzekutivi me relacion, të vijnë edhe komisionet me relacion për temën që diskutojnë. Herë tjetër mos na i harxhoni kohën kot. Ju faleminderit.
Ornildi Demollari: Faleminderit. Faleminderit, është, është e drejtë, edhe ndërhyrja, edhe propozimi që, që kishte kolegu, edhe. Nuk e di a ka vend më për moral të themi apo për thirrje që ju lutem komisionet, komisionet, komisionet. Faleminderit.Po, ju faleminderit. Ermanda, kishe gjë? E kalojmë votim atëherë?
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka.Miratohet pika pesë. Faleminderit. Kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, projektvendim për dhënie ndihmën financiare për familjen në nevojë. Dhe ju e kini materialin, po.

Faslli Zholi: E pamë edhe këtë, familja në nevojë është kjo, mos gabohem, familja që mbajtëm edhe një minutë heshtje. Edhe shpreh ngushëllimet edhe një herë, edhe si këshilltar dhe si qytetar i kësaj bashkie. Dhe dua të shikoj drejtoria financiare për t'i rritur se ndërroi dhjetë dhe vajza. tjetër në këtë dhe prandaj e kam shkruajtur atje, që duhet të shikojnë që këta do të shtimin e kësaj ndihme. Si mbas mundësive, sepse ishin dy, e ëma dhe djali, ndërroi jetë dhe vajzën prapa. Prandaj duhet ta kemi kujdes këtë. Dhe thashë njëherë ngushëllime atij babait dhe të jemi në. Në korent, si këshilltarët, dimë hallet dhe problemet se dikush i dinte, dikush po të mos ndodhte në atë situatë. Ata të sëmurë ishin, po mos i merrte shpirtin. Këtë gjendje, siç edhe, faleminderit të gjithëve dhe u prefshin atje në paqe.

Ornildi Demollari: Po, faleminderit.

Pranvera Begolli: Edhe diçka, meqënëse jemi tek kjo pjesë, është dublimi që thotë Fazlliu. Unë jam tek pjesa e emergjencave. Përshpejtojmë pak procedurat, që të paktën ato çka ju janë dëmtuar në ato banesa të zëvendësohen. Që dhe ata të kalojnë një të përgjithshme. Është

përshpejtimi i procedurave, sepse ato janë procedura, po një përshpejtim, që të paktën, sepse po afrohet ndihmet e tij, është shkatërruar çdo gjë.

Ornildi Demollari: Kuptoj, faleminderit. Kryetar, jemi tek pika gjashtë e rendit të ditës, tek proj Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu ektvendimi për dhënie ndihme financiare për familjet në nevojë. Dhe jemi në diskutime para se ta kalojmë në votim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Përshëndetje të gjithëve, ndjesë për vonesën. Kisha një takim në live. Po ne kemi marrë gjithë masat për të ndihmuar familjen dhe moj rasti i Maliqit është një rast tragjik për të cilën duhet të shprehen ngushëllimet për familjen. Po pavarësisht procedurave ligjore që do të ndjekë Këshilli, Bashkia, ne kemi filluar aty punën konkrete dhe besojnë brenda dy-tre ditësh ambienti do të jetë në gjendje të jetueshme nga biznese të zonës, të cilët po kontribuojnë për ta bërë në mënyrë vullnetare rehabilitimin e tyre. Pjesa tjetër e procedurave ligjore që na takon, apo ndihma e menjëhershme që ne i kemi propozuar këshillit për ta dhënë, besoj, do ketë kaluar ose është në kalim e sipër, ishte një një një vendimarrje e jona që do ta bëjmë për çdo lloj familje, të shpresojmë që të mos ndodhë asnjëherë raste të tilla, por jeta i ka këto dhe ne jemi detyruar ndonjëherë të marrim vendimarrje edhe në pamundësi, por do t'i marrim në çdo rast në qoftë se do ndodhi. Dhe njëherë ngushëllime familjes, faleminderit.

Ornildi Demollari:A kemi gjë tjetër atëherë?

Yllson Ibrahimllari: Nisur nga rasti, një dhimbje për të gjithë ne, gjithë angazhimin nga kryetari dhe nga bizneset e tjera. Nisur në këtë fushë dhe në këtë lloj problematike, fatkeqësitë ne nuk mund t'i parashikojmë, ama nga shërbimi social i bashkisë. Duhet të na vijë, besoj, që në mbledhjen tjetër të vijë një sondim, sa janë mundësitë në kapacitetet njerëzore që ka ajo zyrë të grupeve vulnerabël që ka kjo bashki. Në një bashki që kemi dy mijë e njëqind e ca njerëz me ndihme ekonomike dhe ndërkohë kemi rreth një mijë të tjerë me gjashtë për qind. Nisur nga kjo, unë nuk besoj që e zgjidh ajo gatishmëria dhe emergjenca. Ka studime të tilla, të cilat ne të parashikojmë diku, se mos lëmë ndoshta fasha dhe njerëz të tillë diku tjetër të harruar dhe presin fatkeqësinë e radhës që të reagojnë. Ju faleminderit.

Petrit Kupe:Në lidhje me këtë, Nildi , me këtë problem që po ngrit edhe doktori. Patjetër, bashkia do veprojë kur ndodhin të tilla raste, por e mira është që drejtoria përkatëse në shërbimin social të paraprijë këtyre problemeve. Nuk kam fjalën për raste sëmundjesh, por kam fjalën për familjet, të cilat për arsye dokumentacioni nuk mund të kenë kushte minimale për të jetuar. Në ato banesa, sepse ata nuk janë të aftë të gjejnë një çertifikatë pronësie apo të kenë dokumentacion për banesën në të cilën jetojnë. Ashtu siç veprohet edhe për rastet e zjarrit, që nuk kërkohet dokumentacion për banesën. Ka familje të tilla që duhen ndihmuar, nuk kanë dokumentacion. Duhet një rregullore. Duhet në radhë të parë, duhet të evidentohen nga shërbimi social. Unë di mjaft raste në njësinë e Libonikut që ka banorë të tillë, të cilët nuk kanë kushte dhe nuk kanë dokumentacion që të përfitojnë nga programe që kanë të bëjnë me rregullimin e çative. Pse do t'i

bëjmë këta njerëz të patrajtuar? Duhet të evidentohen për mendimin tim në radhë të parë nga ana e shërbimit social, pastaj të hartohet një rregullore. Me qëllim që të mos abuzohen, ndoshta në një rast, për ta meremetuar çatinë, apo për të meremetuar banesën, apo derën, apo dritaren që e kanë dëmtuar. Të gjenden një rregullore që dhe këta njerëz të ndihmohen të futen në këtë listë dhe kjo kategori nuk është e paktë. Po ta vrasim mendjen, nuk është e paktë. Ai punonjësi që merret me aplikimet për çatitë, kushedi se ka kthyer, që janë në atë gjendje, që janë familje të vetmuara, të sëmurë, po nuk kanë dokumentacion. Si do bëhet kështu do lihet? Do t'u themi atyre që djegin shpinë që t'u rregullojnë. Jo, duhet t'u paraprij. Ka një shërbim social, ka një zyrë urbanistike, ka një preventiv, ka dhe një fond që mund të lihet nga bashkia për ta zgjidhur. Nuk besoj se është shkelje ligjore, ai është një projekt që ta jep qeveria, por bashkia ka vetë iniciativën për t'i zgjidhur probleme. Besoj se kryetari është dakord me këtë propozim. Ka mjaft. Mjaft dhe mjaft shqetësuese, kaq kisha.

Ornildi Demollari: Faleminderit, Petrit, po kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk duhet t'i ngatërrojmë edhe rastin me rastin, pasi rasti i rastit nuk i ngjan. Do të shpjegoj që familja, e cila ishte fatkeqësia që ndodhi në Maliq, nuk ka qenë në kushte të vështira ekonomike nga ana e ndërtesës. Ka qenë në kushte shumë të mira. krahsimisht me familjet tjera, situata që ndodhi, edhe pse shërbimi social trajtonte dy fëmijët, të cilët ishin me probleme dhe nuk ka të bëjë, por. Ka diçka edhe nga ajo që thotë doktori, po dhe që thotë Petriti, që ne duhet ta ndjekim situatën, jo vetëm këtë, por në çdo rast ne duhet ta kemi situatën nën kontroll për të marrë masa parandaluese. Dhe kjo është e vërtetë, sa mund t'i ndihmojnë? Çfarë mund të bëjnë për këtë? Por nuk duhet t'i ngatërrojmë dhe unë duhet të jem shumë i sinqertë me këtë pjesë, jo për t'i hequr përgjegjësinë institucionit në çdo rast kur ne kemi pasi. Nuk mund të kontrollohet në çdo rast një territor apo një numër kaq i madh familjesh në të gjithë territorin e bashkisë, por ama shërbimi social gjithë strukturat tona. Që nga kryetarët e fshatrave, që nga emergjencat civile, që nga gjithë strukturat që ka bashkia administratorët e tjera. Duhet ta dinë situatën në majë të gishtave të themi dhe të bëjnë propozime konkrete për atë punë, sa përsa i përket rehabilitimit të banesave. Që ne bëjmë me projekte që fitojmë nga qeveria, ne e kemi të detyrueshme plotësimin e dokumentacionit. A ka klauzola të tjera? Kjo duhet parë, edhe kjo duhet parë pas rastit, pasi edhe abuzohet. Abuzohet edhe nga familjarë, të themi për familjarë të tjerë. Apo për shpi të cilat ndonjëherë i kanë abandonuar dhe ia ndërtojnë, dhe pastaj i shkojnë t'ia marrin, se s'kanë asnjë letër. Megjithatë, në fund të fundit, një qytetar, një familje duhet të jetë i kujdesshëm, edhe kur blen një shtëpi, edhe kur e merr një shtëpi në ruajtje. Ka mënyra nga më të ndryshme, po pa asnjë lloj dokumenti, nuk di. Ne nuk mund të rehabilitojmë shtëpi, ne mund të ndihmojmë financiarisht. Kur shikohet një rast, ndihmojmë dhe familja me ato lekët mund ta rehabilitojë atë shtëpi. Mund të ketë forma të tilla të ndërmjetme, të cilat duhet t'i gjejmë bashkërisht këshilli, nesë ekzekutiv. Por që ne na takon ta evidentojmë çdo rast dhe t'i bëjmë pamundësisht për t'i ndihmuar ata. Kjo është e vërtetë dhe kemi detyrë funksionale të dy si organe. Ekzekutivi, po edhe Këshilli Bashkiak. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Kryetar, faleminderit. Ajo që ceku petriti, se nuk desha të ndalesha, po është vërtetë një problem që është delikat. Shumë herë shumë familje, të cilat mund të përfitojnë nga programet e rikonstruksionit të banesave, vuajnë për punën e titullit të pronësisë. Nuk e di tek kjo pjesë se çfarë mund të bëjmë ne.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shiko, ne nuk është se kërkojmë gjithmonë çertifikatë pronësie, por duhet të ketë një më të pë ku të figurojë shpija. Që ka marrë, ka marrë tokën, e ka tokën e tij, se s'mund të hyjmë. Ore, kjo është pjesëtimja. Ne si ta evidentojmë që është endja? Ne duhet ta shikojmë ligjërisht, edhe financiarisht. Bazë edhe të shpenzimeve që bëjmë, është bazë jo vetëm për ne që duhet ta bëjmë, audit i brendshëm, kontroll i lartë i shtetit, por ne s'mund të veprojmë qorrazi në kuptimin më të mirë të fjalës, vetëm pse duhet ta ndihmojmë, edhe pse nuk janë lekët e askujt, janë lekët e të tërëve. Po duhet t'i mirëmenaxhojmë sa më mirë, që duhet të gjejmë forma, të cilat të jenë të kontrollueshme. Edhe të shkojnë vërtetë tek këto familje, jam shumë dakord dhe mund të jetë një nga këto, të cilat ne e praktikojmë ndonjëherë, ndihma financiare për familje të veçanta, të cilat mund të jenë në këtë kategori. Dhe ata ta përdorin me këtë qëllim, po ndodh që i marrin këto fonde. I shpërdorojnë, i përdorin për gjëra të tjera dhe shpija ngelet përsëri.

Ornildi Demollari: Mirë faleminderit, atëherë e kalojmë votim?Në qoftë se s'kemi gjë tjetër, jemi tek pika gjashtë.
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet. Faleminderit dhe së sipas rendit, shkojmë tek pika shtatë e rendit të ditës, projektvendim për dhënie ndihmë financiare për familjen ezotit me iniciale V.H., banues në Marliq, dhe zonja me iniciale D.Z., banuese në fshatin Strelcë, njësi administrative Gorë. Banesat e të cilëve u dogjën si shkak i lajnes së zjarrit. Pra, është tek ky projektvendim është ky rasti i Maliqit, që sapo flisnim edhe një rast në Strelcë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kjo është procedurë standarde bazuar në vendimin e qeverisë për raniet e zjarreve, siç kemi praktikuar edhe në rastet tjera. Janë bërë për llogaritjet, është ngritur me urdhër komisioni përkatëse janë bërë për llogaritjet dhe i propozojmë këshillit që nga fondet të cilat ne i mbulojmë, o nga të ardhurat tona, o nga emergjencat civile, t'i përdorim për të mbuluar shpenzimet. Për këtë, sipas detajimit dhe sipas miratimit që këshilli ka bërë në buxhet

Ornildi Demollari: Dhe këtu tek pika shtatë, në këtë moment mendova që të të shqyrtojmë edhe rastin që kishte. Kthyer prefektura, frekuentimi me numër njëqind e katërmbëdhjetë të mbledhjes së kaluar. Po kalojmë një herë këtë. Të kësaj mbledhje, pastaj kalojmë dhe atë e kalojmë votim?

Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet. Faleminderit.Miratohen të dy rastet e rënies të zjarrit.

Yllson Ibrahimllari: Po, tani që e kemi miratuar, që të mos bëjmë dyshimin se do kishim pengesë për zonjën në fjalë. Të marr rastin e Velçanit, që jam shumë afër me Strelcën, kemi pasur edhe këshilltarin tonë, që është administrator i zonës sot. Kryesisht fshatrat e Gorës nuk kanë formularin 001. Shumë banorë të Vëlçanit ik unë nga shtëpia, zhvendosem unë në punë diku tjetër, shkojnë edhe banojnë te shtëpia ime. Zjarri I bie shpisë time dhe ne shpërblejmë atë qeraxhiun që rri te shpija ime. Pse atij janë djegur divanët, ia kam lanun shtëpinë. Tani është shumë urgjente, të paktën për Gorën dhe për Moglicën, të vendosen ato 001-shat që nuk gjenden. Andi thotë, nuk i kam 001. Ishte rasti i zonjës nga Lozhani që erdhi këtu me një vendim të Këshillit Bashkiak për lirimin e rrugës, që s'ekzistonte 001. Duhet bërë një vendimarrje këtu, që e ka më shumë në dorë ekzekutivi, zyra e aseteve, po të paktën të ketë një listim të banesave, pavarësisht se sa do të vlejë kjo zyrtarisht, por të paktën për informacion për ne do vlente.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ky regjistrimi që po ndodh tani nuk zgjidh këto probleme që kemi.

Yllson Ibrahimllari: Nuk e zgjidh, nuk e zgjidh, jo. Nuk e zgjidh, sepse s'e pranon askush.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Andi, si zgjidhet kjo?

Yllson Ibrahimllari: Sepse ja, po të sjell një shëmbull për ta diskutuar. Unë kam ikur një çik më vonë nga ju, nga fshati, ose nga dashuria e madhe kam vajtur sërish. Atëherë, ju lutem, i nderuar kryetar, problemi qëndron shumë i thjeshtë. Xhaxhai im që jetonte deri në moshën tetëdhjetë e pesë vjeç në Vëlçan të Gorës, shtëpia ishte shitur katër herë me firma të fshatarëve dhe të banorëve aty. Zoti Gëzim te Zoti Yllson te Zoti Lulëzim te Zoti Petrit, pra ka katër dokumenta që janë shitur në katër duar dhe në fakt nuk ka çertifikatë pronësie. Është i trajtuar me amtp, ka dhe truall të vendosur aty dhe nuk ekziston lista 001 për Gorën. Për fshatin Velçan nuk ka 001, pra ne nuk e dimë, dhe shtëpitë në regjistrimin fillestar që jam bërë i nderuar kryetar. Shtëpia ime del e regjistruar në emrin e Lulit, që ka jetuar në atë kohë dhe ma ka shitur mua. Ama, regjistrimi fillestar i nëntëdhjetë e nëntë, po themi dy mishit kur është bërë. Gjashtë nëntëdhjetë e shtatë e nxjerr si me pronar të truallit Lulzim Hoxhën në shtëpinë që e kam blerë unë nga Luli. Si zgjidhet? Më fal për këtë punë, unë s'jam specialist i fushës. Nëse, nëse. Atëherë është dakord, problemi kur flasim ka kaq mendje të ndritura këtu. Një nga ata je ti, unë jam Doktor Kockash, po ka thyer njeri këmbët. Më thirr e zgjidh unë. Gjashtëqind e tridhjetë e dy veta, administrata e bashkisë, me tridhjetë e një këshilltarë. Besoj që po ta shtrydhin, ç'i ke gjejmë zgjidhjen? Faleminderit.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula:Përshëndetje të gjithëve atëherë. Shqetësimi që ngre doktori është shumë me vend, por duhet të kuptojmë dy gjëra. Puna e parë. është që në momentet kur është bërë regjistrimi fillestar apo ndarja e tokës në fshat. Që janë mbushur aktet e marrjes së tokës në pronësi, në një prej atyre rubrikave është regjistruar edhe pjesa e truallit. Gjë që bie në kundërshtim me ligjin shtatë mijë e pesëqind e një, që është dhe I vendosur në kokë të aktit të marrjes së tokës në pronësi, që do të thotë që ligji shtatë mijë e

pesëqind e një kishte për detyrë të ndante vetëm tokën bujqësore. Kështu që, për këtë arsye, nuk merret për bazë kur ai është në aktin e marjes së tokës në pronësi, kur trualli është i shënuar atje. Nuk është ligjore. Nuk është ligjore. Kështu, ju lutem me radhë, ju lutem. Përsa i përket formularit zero një, që e quajmë ne, nuk është gjë tjetër. Është vetëm VKM-ja 432, datë 14 shtati nëntëdhjetë e pesë, e cila tashmë është e shfuqizuar. Për zgjidhjen e këtij ngërçi, që është regjistrimi i trojeve në funksion të ndërtimit, në dy mijë e njëzetën ka dalë një VKM që quhet vëkëmëja tetëqind e njëzetë e shtatë. Për momentin, unë nuk mund t'jua printoj, po ju garantoj që me të mbaruar mbledhja mund t'jua jap që ta lexojnë këshilltarët ose në mbledhjen e radhës. T'ia u paraqes atje, i vetmi ndryshim nga formulari zero një është që është lehtësuar puna. Nuk ka më nevojë të firmosë kryeplaku, kryetari i ish-komunës apo i njësisë administrative, atje thjesht bëhet një aplikim tek i e-albenia, i cili në dijeninë time nuk ka ndryshuar, dhe me ndryshimet e tarifave është dhjetë mijë lekë të reja dhe ka një procedurë gjashtë mujore për të mbledhur gjithë dokumentacionin dhe hetimin, nëse kjo shtëpi, siç e tha edhe i nderuari doktor. Kjo shtëpi ka qenë timja, apo nuk ka qenë timja përpara nëntëdhjetë e njëshit? Me tu bërë hetimi administrativ. Këto regjistrohen dhe qytetari merr dokumentin e pronësisë, kështu që të gjithë zonat të cilat nuk e kanë formularin zero një apo e kanë me mangësi dhe ASHK-ja nuk e merr të mirëqenë, duhet t'i drejtohen portalit të e-albenias për të aplikuar për VKM 827, tani këtu lind problematika dhe themi që në rast se. Do aplikojnë të gjithë, do ketë fuqi dhe kapacitet për t'i përballuar të gjithë. Kjo është pjesa tona si bashki dhe me ndihmën e kryetarit, duke i vendosur në dispozicion edhe grupet tona, siç po bëjmë për regjistrimin e këtyre zonave të cilat nuk janë futur në sistem. Dhe ne jemi duke i futur tani së fundmi. Në mënyrë që brenda këtij gjashtë mujori, po themi që ligjvendësi ka parashikuar qytetarët të pajisen me çertfikatëpronësie, por kjo është e vetmja zgjidhje.

Ornildi Demollari: Shumë me shumë vendime, shumë ne vazhdojmë vuajmë për formalizimin e pronës.

Yllson Ibrahimllari: Banorët mund të mos duan t'i regjistrojnë vetë banesat për një arsye të vetme, sepse unë kam dy banesa në emrin tim dhe paguaj tatim të dyfishtë kur regjistroj banesën e dytë. Të mos gabojnë dy mijë e katërmbëdhjetën, dy mijë e pesëmbëdhjetën qeverisja, qeveria e kohës, por që ka dhe vazhdimësi mazhoranca aktuale. I është drejtuar gjykatës së Strasburgut për korrigjimin e titujve të pronësisë dhe kishte parasysh, nuk e kam këtë vendim, po do t'ia çoj me email dhe kishte parasysh korrigjimin e titujve të pronësisë atje ku ka defekte. Deri para pak kohësh, edhe ju i rregullonit këtu në këshilla AMTPTË kur kishte probleme kishit një periudhë kohore para se të dilte 2020. Dhe Strasburgu është përgjigjur ekzaktësisht, duke e cituar jo ligjërisht, por po ju them me fjalë sa më të thjeshta. Nuk do të lejohet asnjë tentativë mbi ndërhyrjet e titujve të pronësisë. Pra, nuk ka asnjë fuqi mbrapa, askush të rrëzojë AMTP. Mund të mos kesh çertifikatë pronësie, po AMT-ja nuk rrëzohet, nuk goditet. Vetëm kur ka vullnet, siç ishte rasti që na e lejonte ligji për atë truallin që kemi te AMT-ja, nuk e ndryshojmë dot. Do jetë truall. Ju faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë një gjë, unë një gjë mund ta them që në qoftë se ka një klauzolë që s'është tetëqind e njëzet e shtatë, ai thotë Andi. Ndoshta kjo ka, duhet të bëjmë një informim publik. Që njerëzit ta marrin vesh, po ndoshta nuk e dinë, nuk besoj se mund të jenë të gjithë të asaj kategorie që kanë dy shpi, edhe merakut që paguajnë tatim të dyfishtë. Por mund të jenë banorë qytetarë, shumica besoj do të jenë kështu, që kanë një shtëpi dhe nuk kanë informacion për këtë punë. Pse mos e bëjmë.

Yllson Ibrahimllari: Por dhe unë shumica janë me dy shtëpi, se gjithë Velçanakët i ke te Kneta. Unë nuk dyshoj që me vullnetin tend dhe me mundësinë që po t'i hypim tan makinës të shkosh deri te hipoteka, të paktën Gorën e Moglicën i mbaron për dy javë. Çfarë na gjejnë nesër nëse drejtoreshën e ftojmë në këshillë drejtoreshën?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë dje kam patur një takim me drejtoreshën e katastrës për problematika që ne kemi, mund të jetë edhe kjo ta lëmë për diskutim, megjithëse unë i qëndroj prapë para se se Andi nuk ma pranon. Që amëtëpëja për mua është një dokument zyrtar që është dhënë në një kohë. Pavarësisht ngërçeve që ka, po aty ke një, ke një dokument, se ku s'ke fare, s'ke fare.

Yllson Ibrahimllari: Mua ma ka dhënë Ramiz Alia, se s'ka marrë tokë fare. Unë po po them se ishte në nëntëdhjetë e njëshin mazhorancë. Petritit ia ka dhënë Saliu, se ia ka dhënë me për agranomët, dakord, ta gëzosh mo, po ai ta zgjidhim, faleminderit.

Petrit Kupe:Në kuadrin e shkresave të burokracisë dhe ligjeve, më duket pak e vështirë. Por që në fillim, që dikush nga aplikimi nuk arrin ta bëjë dot me hipotekën. Unë kam rastin tim me hipotekën dhe nuk kam marrë certifaktën e pronësisë, sepse hipoteka do të vijë të bëjë një azhornim të pjesës së sipërfaqes ku janë ndarë ato toka. E kam dhjetë vjet se kam marrë, e nuk pres ndonjë gjë ta marrë. Por ky hap jep një dritë jeshile që tregon që ka një mundësi po të angazhohet ky me ekipin e tij, a mund t'i bëjë këto korrigjime që kanë të bëjnë me azhornimet, siç bën azhornimin e asaj toke që do jepeshe qira. Ka mundësi dhe po të vihen në punë të atë hipotekës, mund të bëjnë.

Ornildi Demollari: Faleminderit tani këtu tek pika shtatë. Gjykoj nëse biem dakord që atë vendim të cilin të mbledhjes së kaluar, të cilin ka kthyer prefektura, ta. ta ta rimiratojmë duke i kërkuar përfaqësuesit të emergjencave atë relacionin që kërkonte, e kemi ndryshuar. Mund ta kalojmë në votim atëherë. Atëherë jemi tek projektvendimi me numër për rishqyrtimin e vendimit numër njëqind e katërmbëdhjetë, datë tretë i nëntit dy mijë e njëzet e pesë për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e Pojanit.Është rasti i familjes së Pojanit, apo jo? Mund ta rimiratojmë edhe një herë këtë?

Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.

Abstenim.Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Shpresoj që të të vijojë me procedurën dhe të mos vonohet. Ky si material, edhe ekzekutimi i tij. Atëherë kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës, që është projektvendim për detajim fondi sipas aktit normativ me numër tetë i dhjeti dy mijë e njëzet e pesë, po Petrit, komisioni.

Petrit Kupe: Komisioni e pa edhe këtë projektvendim dhe dy projektvendime të tjera shtesë që kanë të bëjnë me ne. Për projektvendimin numër tetë bën fjalë për një shpërblim. Të akorduar nga Këshilli i Ministrave për Shërbimin Zjarrëfiks. Patjetër, ky është një shpërblim i pritur, i mirëpritur prej kohësh, prej disa muajsh dhe bashkia ka marrë masa e ka detajuar hollësisht këtë. Sepse ai ka ardhur në total sipas. Sipas një provendimi, kryetari na e paraqiti në komision. Ky shërbim prej nëntë pikë katër milionë lekë, nëntë pikë katër milionë lekë të vjetra. Kalon për shpërblime për punonjësit zjarrfikës 2.5 milionë lekë të reja. Për paga katër pikë dyzet e pesë milionë lekë të reja, për sigurimin shoqëror shtatëqind e dyzet e dy mijë lekë të reja, dhe për blerje veshje zjarrduruese një milion e tetëqind mijë lekë të reja, patjetër që është një P-V i rëndësishëm që miratohet, besoj të dy pretendimet e tjera për mendimin tim janë mendime që janë të domosdoshme, të cilat kanë të bëjnë me sportin dhe me kulturën me vlera jo shumë të konsiderueshme dhe kthehemi dakord që të kalojë. Kryetari mund të bëjë ndonjë shpjegim tjetër, po urdhëro.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shpjegim në lidhje me e shpjegoi Petriti këtë, se këshilltarët kanë një projektvendim për fondin që ka ardhur në aktin normativ në total dhe ne e kemi vetëm.

Ornildi Demollari: Pika tetë po i bashkovi Petrit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po kemi bërë një detajim derisa Drejtoria e Financës bëri një kalkulim të vlerave dhe, siç e shpjegoi, kalon shpërblimi, kalon mbulimi i pagave i sigurimeve shoqërore. Edhe një fond për blerje e veshje zjarrduruese, të cilat ata e kanë të domosdoshme, janë fonde të cilat janë të dedikuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe ne s'kemi ku i çojmë në vend tjetër, por shyqyr që kanë ardhur dhe mbulohen disa shpenzime shumë të domosdoshme. Shpenzimet e tjera, ajo e veshjeve popullore janë fondet në buxhet, por është ndryshuar vetëm struktura buxhetore nga 602 që kanë qenë shpenzime operative në atë 231, që ato të jenë materiale inventari, të mos të regjistrohen, mos dëmtohen. Dhe një fond pastaj për blerjen e uniformës sportive për klubin e futbollit. Kështu munduam të gjenim një sponsorizim, nuk gjetëm. Atëherë u detyruam ta mbulonim me fondet tona.

Ornildi Demollari: Faleminderit atëherë, tek pika tetë një herë për detajimin e fundit, pastaj për blerjen e kostumeve kemi dy materiale më vonë, më pas. E kalojmë votim, atëherë pikën tetë apo ka ndonjë gjë për të shtuar? E kalojmë votim? kush është dakord? Edhe një herë, ju lutem?

Kush është dakord? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.

Abstenim.Nuk ka, Miratohet.Faleminderit.Kalojmë tek pika nëntë projektvendim për konfirmimin e inventarizimit në mënyrë të gabuar të pasurive me numër njëqind e nëntë fraksion dyzetë e shtatë zona katastrale dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër në fshatin Plasë, Njësi administrative Poja në në listën e inventarit të pronave të transferuara me VKM, numër një mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër, datë trembëdhjetë i teti dy mijë, dy mijë e tetë, besoj, apo dy mijë e tetëmbëdhjetë? Dy mijë e tetë, se këtu është bërë dy mijë e njëzetë e tetë. Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Pojan, qarkut të Korçës. Atëherë, Andi, do ta sqarosh diçka këtu? Çfarë është kjo?

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Atëherë, përsa i përket këtij projekt vendimi? Një qytetar, i cili, siç e theksuat edhe ju, është banor i fshatit Plasë, ka aplikuar pranashëkësë për regjistrimin e shtëpisë të vet, nëpërmjet VKM-së tetëqind e njëzetë e shtatë. Dhe nga korrespondenca që ASHK-ja kryen me bashkinë, i ka rezultuar që kjo ka qenë pronë e inventarizuar në listën e pronave që dispononte bashkia. Nga verifikimi që është kryer në terren, rezulton që ky verifikim konstatoi që objekti ishte i ndërtuar para nëntëdhjetë e njëshit. Dhe ishte shtëpi banimi dhe më përpara dhe më pas dhe na rezulton që inventarizimi do jetë bërë gabim ose mund të ketë pasur ndonjë dublim numrash për të cilën ne nuk i referohemi dot pasurisë në fjalë, domethënë. Kjo është arsyeja që po e po bëjmë rregullimin e inventarit, jo se po i nxjerrim gjë nga inventari jonë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, Andi ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim?
Kush është dakord? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Dhe kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që është pika dhjetë. projektvendim për miratimin në parim të zhvendosjes së lapidarit përkujtimor të terrenve të luftës, që ndodhet në pasurinë me numër shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë zona kadastrale dy mijë e katërqind e dyzetë e pesë fshati Libonik, njësi administrative Libonik dhe në do të do ta do zhvendoset në vendndodhjen e re në pasurinë me numër një mijë e njëqind e katërmbëdhjetë Fraksion tetëdhjetë zona katastrale, dy mijë e katërqind e dyzetë e pesë, e njëjta zonë fshati Libonik, njësi administrative Libonik. Pra, është fjala për zhvendosjen e një lapidari të luftës të të rënëve të luftës nacionalçlrimtare. Po.

Petrit Kupe: Po unë, unë jam pro njeri që patjetër do të zhvendoset ai lapidar, mbasi vendi është shumë i ngushtë dhe. Por nuk jam dakord për ku kam menduar. Lapidarët janë monumente historike, të cilat duhet të ekspozohen. Komuniteti ti shoh. Të jenë në vendet e ekspozuara, që të kujtohen dhe të shikohen vazhdimisht. Aty ku është menduar, unë i nuk jam dakord. Është hequr që nga ana në rrugë, që duket nga rruga dhe është vendosur mbrapa një shtëpie, që aty kalojnë vetëm ata që bëjnë gjimnastikë në mëngjes nja pesë veta. Shiko një vend tjetër, ka vende.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po mund ta sqaroj, është ne kemi çuar në një pozicion, i cili duket nga rruga nacionale, është në piedestal. Dhe po të shkojmë bashkë ta shkelim, do të

pëlqejë edhe vendi, duket nga të katër anët, megjithatë, ne ta miratojmë në parim zhvendosjen dhe hajde ta përcaktojmë vendin. E para duhet të jetë tokë shtetërore.

Petrit Kupe: Unë s'jam dakord për vendin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Vendi është shumë shumë i mirë, nuk është mbrapa shtëpisë, aty ku është në rrugë. Më lart, më lart, po që duket kur vjen nga Korça. Kur vjen nga Korça, ajo duket si në.

Petrit Kupe: Po nuk duket kryetare, thashë, nga Korça do të ngresh, do të ngresh kokën, të shikosh nga lapidarin nga Korça. Do të vënë një vend që duket normalisht, është gjithsesi. Juve që e dini ku është, e shikoni.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë them të bie, bile nuk do vendoset, se ne do ta rehabilitojmë atë nuk do ta lëmë në atë gjendje, do ta bëjmë më të madh, do ta veshim, dakord, do ta, do ta sistemojmë që ajo të marrë formë diçka më. Po patjetër, megjithatë, unë them ta miratojmë lëvizjen dhe bashkërisht ta shikojmë që të bëhet më mirë, se ne nuk kemi mundësi tjetër.

Yllson Ibrahimllari: Ju faleminderit në të gjitha këto projektvendimet për zhvendosje për këto rehabilitime. Një gjë nuk kam parë kurrë të shkruar. Si qëndrojnë këto iniciativat tona të ekzekutive dhe tonat bashkarisht në lidhje me planin e përgjithshëm vendor të miratuar? Në katërmbëdhjetë i dhjeti dy mijë e njëzetë nga KKRT-ja dhe që jeni dhe ju firmosës i nderuar, kryetar i këshillit, kryetar i bashkisë, zonja që është shefja urbanistike, s'do t'ju lutesha në rastet e tjera. Në parim, dakord, bile s'duhet të ketë edhe disa lapidarë të tjerë, bile s'mund të marrin. Iniciativë për Maliqin, po ngaqë na i zgjatnin nja dy vjet ato titujt e nderit, nuk e dimë a kemi mundësi t'i miratojmë dot ne derisa të na mbarojë mandati. Paraprakisht do të thosha edhe një herë i lutur, sepse në qoftë se ne vijmë dhe korrigjojmë vendime dhe sillemi në këtë mënyrë, kur na i ka thënë shumë mirë ai plani i përgjithshëm vendor që keni miratuar, në katërmbëdhjetë i dhjetë i dy mijë e njëzetë, me vendimin numër pesë të firmosur nga Kryeministri, atëherë është e kotë. Nëse aty është territor që e lejon këtë hapësirë shumë mirë, dakord. Por në këto projekte që na vijnë, të paktën zyra e urbanistikës të na konfirmojë, që nuk bie ndesh me planin e përgjithshëm vendor dhe diçka tjetër, ne kemi zonjën këtu e kemi respektuar edhe më shumë ju se sa unë, e cila vjen edhe te komisioni i titujve nga organizata e veteranëve. Të na japin një opinion ajo si qëndron me grupet e interesit ky propozimi juaj. Ju faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kryetar mund të shpjegojë diçka. Tani, plani i përgjithshëm mendor, jo se përcakton çdo element, por. Ka një të drejtë doktori kur thotë që a bie ndesh me ndonjë, me një rrugë, me një kanal, me një tjetër dhe patjetër që është parë dhe. Ajo ka kaluar, pavarësisht se nuk është shkruajtur. Vërejtja është me vend që ne duhet ta citojmë në një paragraf të projektvendimit apo të relacionit që nuk bie ndeshëm me planin e përgjithshëm vendor që ne kemi miratuar.

Ornildi Demollari: Po faleminderit, atëherë po Selami.

Selami Muço: Aty në fshat Maliq është një lapidar kushtuar dy dëshmorëve, ndërsa shumica moshë e kaluar mund t'i dinë ata, jo Selenica dhe Xhevit Gaskova. Ajo është në një gjendje të mjerueshme, edhe është e mira që të mos jetë fare. Nuk ka ndonjë problem, qoftë se ka probleme. Ku di unë çfarë? Se ai është fare domethënë, po më sej me për turp. Thuajse nuk ekziston, është më mirë të fshihet anës së rrugës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk mund të thuhet, s'mund të ekzistojë. Aty ka një problem, ne e kemi rehabilituar disa herë.

Selami Muço: o, mos ekzistojë në kuptimin. Nuk ka një.

Ornildi Demollari: Ashtu si është, më mirë mos ekzistoj.

Ornildi Demollari: Ka një problem. Me zonën me pronarët, ne të themi, dhe ne po mendojmë që ta lëvizim nga ajo zonë, pa ndërtuar diku në të. Në dalje që ikën për në Goçë në drejtim të fshat Maliqit, po ku ikën për në Vorrezat. Dhe në momentin që do jemi gati, patjetër do ta diskutojmë. Po faleminderit.

Yllson Ibrahimllari:Këtë, duke qenë se figura më përbashkuese e Gorës, që nuk lë asnjë lloj, asnjë lloj, dhe i Maliqit dhe i Rezës, po aq më shumë edhe i Korçës, nënkryetari i Republikës Autonome të Korçës. Zoti Kajo Babieni, na erdhi një projekt, do t'i restaurojmë varrin para ca kohësh. Nuk e di, e zgjidhet ju shumë mirë vetë. E di pa diskutim, e di që e keni bërë, po i sollët në këshillë, pastaj e bëtë në ato metodat. E kërkuan këtu me shkresë njësi administrative. A ka mundësi që këtij njeriu? Që të tjerët nuk i kanë, i bëjnë prej balte. A ka mundësi në një lulishte të bashkisë së Maliqit t'i vihet një emër, një rruga, t'i vihet një busta, t'i vihet një, një gjë? Ju faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në fakt, është një emër vërtetë për tu për tu vlerësuar dhe do na bënte nder në qoftë se do ta realizonim. Ndoshta unë mendoj. Lulishtja apo një rrugë mund të ishte gjëja më e thjeshtë, po ngritja e një busti në emrin e tij do ishte shumë shumë pozitive. E ndoshta na shërben të gjithëve për të dhënë disa ide dhe disa mendime.

Yllson Ibrahimllari: Edhe nga shoqëria aksionere e kombinatit mund t'i themi verës, sepse ngaqë themi ta mbyllim dhe vazhdojmë votojmë, mund t'i marrim nga fondet e verës. Kur të vijë, ia them vetë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Duhet parë si rast, edhe unë bie shumë tepër.

Ornildi Demollari: Faleminderit, po Lola.

Floreta Zaçe: Faleminderit, pajtohem me. Kolegun, për arsye të venitur të rrugëve apo të lapidarëve apo të ç'mund të diskutojmë këtë, që të vijmë të dalim në atë që ne kërkojmë. Unë kam kërkuar edhe herë të tjera, që përsa i përket rrugëve, mundësitë janë shumë të mëdha. Unë diskutoj, po Pojanin që është shumë i madh, që kam kërkuar që të ketë çdo rrugë të ketë emrin e të rënëve apo të njerëzve që kanë dhënë kontributet gjatë punës së tyre në fusha të ndryshme. Nuk e kam marrë një përgjigje, ndoshta do të diskutohet a do të bëhet. Kam dhe një rast konkret, kam biseduar edhe me kryetarin për atë. Unë sot e quaj pedonale atje në Pojan edhe atje kemi një kanë janë pushkatuar gjithë ata njerëz dhe të ketë një emër edhe ajo vendi atje. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.

Petrit Kupe:Në të gjithë njësitë vendore është bërë një projekt dhe një program nga qeveria për emërimin e gjithë rrugëve. Nuk besoj se në njësinë e Pojanit të ketë rrugë pa emëruar apo jo kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të ketë pretendime për rrugët dhe këto ndryshime. Në varësi, por duhen parë dhe unë e kemi diskutuar disa herë këtë problem. Vendosja e emrit të rrugëve hyn në të gjithë pjesën e gjendjeve civile dhe çdo fëmijë që lind nuk mund ta regjistrosh, po s'ka emrin e rrugës. Dhe kjo mund të krijojë një anomali shumë të përgjithshme në qoftë se ne ndryshojmë emrat e rrugëve çdo ditë. Mund të ketë propozime konkrete për ndryshimin e një rruge të një sheshi, por s'mund të hyjmë në shumicën e rrugave, sepse bëjmë një kakofoni shumë të madhe, e cila mund ta krijojë problem. Ajo çfarë tha të dytën për sheshin e Pojanit, jam dakord, duhet gjetur një që të vendoset një pllakatë dhe duhet gjetur një emërtesë që do ta personifikojmë atë emër, atë që ka ndodhur, kurse pjesa e rrugëve është çik problem që duhet diskutuar edhe në rrugën e drejtorisë së planifikimit të territorit, edhe me administratorët, për ta parë në çfarë situate jemi. Por çdo rrugë, në çdo fshat, pavarësisht se kemi mangësi në vendosjen e tabelave, që edhe këtë duhet ta shikojmë, por çdo rrugë ka emrin e saj.

Floreta Zaçe: Po ato emrat që janë kryetar, janë emra domethënë rruga e shtrembër, rruga e drejtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të lutem shiko, ky është moment tjetër, por ish-këshillat e komunave. Kanë marrë një vendimarrje për emërtesat e rrugëve. Ka qenë dhe një moment i dytë që na është dhënë e drejta si këshillë bashkie për të bërë ndonjë rregullim se mund të kish mbivendosje, mund të kishte të njëjtin emër rrugë edhe Liboniku dhe Maliqi dhe të vinin me një. U bë një punë atëherë, ndoshta rasti i Pojanit nuk di, ju mund të keni qenë anëtar i këshillit atëherë dhe duhesh parë, ose duhet parë çfarë probleme ka, sa mund të ketë ndonjë që nuk shkon si emërtesë dhe mund të rregullohet.

Floreta Zaçe: Emërimi e pedonales, siç e thamë më sot, të qendrës kombinon me datën njëzetë të shkurtit të pushkatuar dhe kemi dhënë rastin konkret të de të bënte dhe kemi rënë në dilemë për këtë gjest që sillte nga vendosim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, ju lutem, bëni një propozim që të t'i vlerësoj ata që kanë bërë, por tjetër t'i rezistoj dhe kohës. Jo gjithmonë duhet t'I duhet t'i shikojmë politikisht gjërat, duhet t'i shikojmë për të vlerësuar që nga koha e hershme deri më sot dhe vërtetë të vëmë një që të edhe më duket vetëm mënyrën se si do ta konceptojmë, nuk kemi rënë dakord, se duke qënë që është një shesh në qendër të Pojanit. Nuk e di çfarë s'shkonte në ai propozimi që bëmë?Edhe mbeti, duhet gjetur edhe një çik i kohës, po për ta personifikuar dhe atë që kanë bërë ata, nuk e di.

Ornildi Demollari: Atëherë, ju lutem, kalojmë në votim? Kush është dakord me zhvendosjen? E Lavidarit 19 vota pro.
Kundër? 1 votë, Petrit Kupe.
Abstenim.Nuk ka.Po ka një kundër, a po më fal për zhvendosjen apo për? Dakord, me një kundër, me një kundër, po miratohet, sepse janë shtatëmbëdhjetë vota, tetëmbëdhjetë vota pro. Faleminderit. Dhe ecim me materialet e tjera që kemi. Jemi tek pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin në parim të një ndryshimi në sistemin ALFIS të ekonomisë pyjore në Mesmal. Po, Luli, deshe fjalë?

Lulëzim Hoxhaj: Unë së pari një herë dua të sjell prapë në vëmendje ato mendimet që u trajtuan që në fillim të kësaj mbledhje për funksionimin e mirëfunksionimit të komisioneve.Sot një kandidat i ri me ka rruga anëtar i Këshillit të Bashkisë. Dëgjuam edhe betimin të tërë e kemi bërë atë. Që në fillim të herës kemi thënë, betohemi do të jemi të rregullt, do të përkushtohemi, etjera, etjera, etjera. Si duket, ka qenë vetëm çështje betimi. Unë me thënë drejtën, me thënë drejtën, kam. E kemi trajtuar edhe herë të tjera dhe i kemi sjellë në vëmendje këtë me fjalë. Në rast se duam të bëjmë propagandë, propaganda bëhet në këshillë, mbledhjen e këshillës së bashkisë. Në rast se duam të zgjidhim ndonjë problem, ato bëhen nëpër komisione, atje ku mund të bëhet edhe debat, edhe diskutim më i specializuar. Debati mund të jetë më i hapur. Profesional, sepse janë zgjedhur anëtarët si mbas profesionit dhe si mbas asaj. Për çështjen në fjalë, ne u mblodhëm dje si komision. Kemi edhe një raport vendimarrje, për këtë, me fjalë në përputhje me atë që është paraqitur këtu. Çështja është e qartë në fjalë, sepse është diskutuar edhe më përpara në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Bëhet fjalë për një gabim të hedhur në nga në hartë, nga firma që e ka trajtuar këtë firmë e caktuar nga dy ministri, Ministria e Medisë dhe Ministria e Kulturës. Bëhet fjalë për firmën Alpkos. Dhe çështja është me fjalë që devijimi është jo i vogël, bëhet fjalë për një devijim goxha të madh për lumin në mesmal. Ne e pamë materialin dhe komisionin me fjalë është i, jo është i mendimit, po kërkon nga ky këshillë me fjalë, të miratohet dhe të vendoset korrigjimi. i pjesshëm me fjala korrigjim, që është trajtuar edhe nga ajo kontrolli që ka bërë Ministria, rikontrolli, që ka bërë Ministria. Ky korrigjim të hidhet në sistemin alfis, nuk menjëherë të hidhet atje dhe ndërkohë, ftojmë edhe këshilltarët që të, përveç këtij, asaj me fjalë të bëhet edhe shfuqizimi i pjesshëm i vendimit të Këshillit Bashkiak të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë, një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një. Të shkresës numër tridhjetë e shtatë, data njëzet e tetë, i pesti dy mijë e njëzet e një. Kjo është shumë e rëndësishme për arsye sepse po them i pjesshëm të shfuqizohet ai vendim i pjesshëm që ka të bëjë vetëm me këtë çështje.

Ornildi Demollari: Çfarë është ky vendim për çfarë është bërë?

Lulëzim Hoxhaj:Në vitin shkresa e datës, domethënë shkresa tridhjetë e shtatë e datës njëzet e tetë. I pesë i dy mijë e njëzet e një në këshillin bashkiak, këtu në këtë këshill bashkiak, jonë paraardhësit është vetëm dy e njëzet e njëshin me fjalë, kur para se të vinim ne këtu. Është marrë një vendim, si duket është trajtuar, është vendosur që harta e asaj do të jetë kjo hartë që u paraqit në atë kohë nga firma. të nga po kjo firmë nga Alpkosi me fjalë. Ky korrigjim, duhet të shfuqizohet, domethënë ky duhet të futet dhe të kërkohet të bëhet shfuqizimi i pjesshëm me fjalë për këtë pjesë.

Ornildi Demollari: Po e kuptova. Mirë dakord, nuk e di përfaqësuesi të ta shikojë zyra juridike, se e kemi ju.

Lulëzim Hoxhaj: Paraprakisht, po them që të paktën këtë pjesë, domethënë e kemi. Para se të bënim edhe këtë takimin me komisionin, unë e kam konsumuar edhe në jurist këtë. Që është e domosdoshme që një vendim i pa ashtu që është bërë mbi bazën e atëherë janë dhënë shifra edhe pozicione të gabuara. Patjetër duhet të shfuqizohet ai vendim për këtë pjes

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk ka vendim i këshillit, harta, koordinata. Aty ka vetëm një miratim të planit të mbarështrimit, sE mos të them gabim, nocionin të ekonomisë pyjore mesmaj, po me koordinatat që janë ato. Tani ky ndryshim automatikisht e ndryshon atë vendimarrje se thotë të rregullohet kjo pjesë që është hedhur gabim dhe i kërkon studios. Sipas propozimit që bën Ministria, bashkë me Drejtorinë përkatëse, me sektorin e pyjeve e kullotave në bashki, që të bëhet ndryshimi.

Yllson Ibrahimllari: Iniciatori për ta futur në këshillë kam qenë unë, bashkë me një grup këshilltarësh. Falenderoj gjithë këshilltarët e Pozitës për mbështetjen për ta vendosur atë projekt para disa mbledhjes së këshillit. Në vitin dy mijë e njëzet e një, me vendimin numër tridhjetë e shtatë të Këshillit Bashkiak, kini miratuar planet e mbarështrimit të ekonomive pyjore gjashtë shtatë tetë. Bashkë me hartat bashkëngjitur, hapni vendimin e keni të cituar.Bashkë planeve,

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dakord, patjetër, por kur të vijë ndryshimi nga studioja me propozimin e cituar, do të vijë me gjithë, se do të merret një vendimarrje prapë. Studioja që do të bëjë ndryshimin, se nuk e bëjmë ne.

Yllson Ibrahimllari: Cila studio? Po nuk e bën në studio,

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po kush e bën?

Yllson Ibrahimllari: Ja do ta them, këtë po bashkëbisedojmë në qoftë se do më japësh hapësirë. Në qoftë se dua, e kam më shumë për të informuar këshilltarët, sepse ju mund ta dini edhe më mirë këtë çështje se sa unë. Atëherë, shoqëria Apkons është rekrutuar nga Ministria e Mjedisit,

Turizmit. Si ka qenë atë kohë se i ka ndryshuar emrin ta shihesh vetëm në mjedis? Ka rekrutuar një kompani private, e cila ka hartuar planet. Kompania e ka dorëzuar produktin e vet. Ka ikur kompania, nuk ka më kompani me tërësi. Atëhrësh, pse është vënë të korrigjohet në sistemin alfis? Sistemin Alfi sot e menaxhon Agjensia Kombëtare e Pyjeve dhe Drejtoria Pyjore në Bashkinë e Maliqit. S'doni ta bëni, mos e bëni. Por duhet të kuptoj, të lutem, nuk kam asgjë personale. Të lutem, më lejo të shpjegoj që të kuptoj ndonjë gjë, edhe nga relacioni e tjerë. Kemi një vendim që ka miratuar një hartë në dy mijë e njëzet e njëshin, bashkarisht, në parim. Ja keni çuar Ministrisë që jeni dakord. Dhe filloi dhe një herë atje ku i fillova t'i bija gajdes me një vrimë, siç duket në këtë këshillë bashkie. Po të ishte konsultuar kjo harta me planin e përgjithshëm vendor, siç e keni, nuk do ishim në këtë pozitë. Dhe këshilltari i Gorës, kushërira ime më duket ka qenë në atë kohë, me mbiemër Koçllari.Problemi qëndron, do ishte zgjidhur çështja e që atëherë. Tani Ministria, me iniciativën tonë të gjithë bashkë, me ndihmën tënde shumë që e nisi atë shkresë, nuk u vonua. Konstatoj që ajo që kishim ngritur njësi shqetësim në këtë zyrë është e drejtë dhe neve nuk paskërkemi folur kot. Atëherësh, kryetari tha shumë mirë ta vlerësojë ministria, shumë mirë ta vlerësojë shoqëria që e ka bërë, shoqëria i ka marrë lekët. Shoqëria i ka marrë lekët, nuk të vjen më shoqëria. S'ka asnjë punonjës. Shoqëria APKOS ka administrator Besnik Leskajm. I di lidhjet, nuk ka nevojë për t'i bërë publike dhe ndërkohë e ka mbyllur projektin. Nuk ka as GIPIES, siç kemi petrikën ne, as dikë tjetër.Agjensia kombëtare dhe agjensia që vendosi ta sjellin. Tani problemi qëndron. Sa shpejt do ta bëjmë në Alfisin? Se kemi dhe një bisedë tjetër bashkë. Sa do ta azhurnojmë në Alfisin qëndror këtu? Sa të sa kapacitete njerëzore inxhinierike kemi ne ta punojmë? Ky nuk është një problem, se ne kemi kapur vetëm një segment. Ai lumi ka edhe probleme të tjera. Është ngritur aty ajo harta tjetër e malit të thatë, mund të ketë probleme të tjera. Ne ndodhemi përballë një fakti, ne po miratojmë sot një vendim dhe faleminderit që e ke sjellë, qoftë edhe me Alfisin. Juridikisht, një vendim i mëvonshëm e rrëzon të parin, por ne po mbajmë në këshillë bashkiak, po krijojmë precedentin që të mbajmë dy vendime që kanë të dyja forcë juridike. Edhe tridhjetë e shtata me hartën e gabuar, edhe vendimi si do t'ia vini emrin sot, me hartën e rregulluar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani unë ju kam sjellë një projektvendim sipas propozimit që ka bërë Agjensia Kombëtare e Pyjeve fhe thotë për sa më sipër, struktura përgjegjëse e pyjeve në Bashkinë Maliq, në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Pyjeve, mbështetur në provat dhe argumentet e mësipërme, të kryejnë ndryshimin në sistemin e Alfis dhe bashkëlidhur fragmentin e hartës, që është ky. Këtë punë do bëj dhe kjo automatikisht ndryshon me ndihmarrjen që tha pak më parë Luli. Edhe mund të shkruhet atje, sepse s'përben asnjë gjë të keqe.

Yllson Ibrahimllari: Po vendimet që kishte marrë ai që iku në Amerikë kur e zëvendësove ti, a u shfuqizua ndonjëherë nga ti? Një pasardhësi jot që para se të zgjidheshe ti, ndonjë vendim që binte ndesh në bashkëi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Zakonisht mundohem që të shikoj përpara dhe të ec përpara dhe nuk merrem me vendimarrjet që kanë marrë përpara meje. Në qoftë se ka një problematikë ligjërisht që duhet rregulluar, patjetër.

Yllson Ibrahimllari: Më fal, një pyetje kam. Këto më fal, pardon, zoti kryetar, jo në fjalor njohës më shumë. Këto projektvendimet ne na i hartojnë juristët e bashkisë, sepse s'kemi kapacitete ne si këshillë, edhe për t'i vlerësuar juridikisht. A ka mundësi që ata juristët që hartojnë këto projekte të vijnë edhe të japin përgjigje? Kemi dy vendime të Këshillit Bashkiak, të dy me forcë ligjore, janë të dy në fuqi. A bien ndesh këto të dy?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Vendimi që merr sot këshilli e ndryshon vendimarrjen që ka qenë në dy mijë e njëzet e njëshin kur ka qenë. Patjetër, se ne do të ndryshim, do të hyjmë në sistem me këtë vendimarrje që ju do të merrni për të ndryshuar njollën të lumit, edhe , patjetër.

Yllson Ibrahimllari: Jo mo, lumi s'ka lëvizur nga vendi. Harta ishte e gabuar. Lumi, ne do rregullojmë hartën. Lumi atje ka qenë në të gjitha kohët.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kjo automatikisht i ndryshon a duhet shtuar ajo që shprehja e vendimit pa shikojnë juristët le ta bëjnë.Ta shikojmë shfuqizimin pjesor, ta shikojmë me zyrën juridike, por është marrë tekstualisht ajo që është shkruar këtu edhe për të shpjeguar diçka, doktor. Që kur miratohet një vendimarrje nga këshilli i bashkisë, po them për koordinatën e planit, miratimi i planit të përgjithshëm, që the pak më parë këshilltarët e parë, nuk do hyjë këshilltari a bie lumi atje, se nuk e gjen dot as ne. Nënkupton që atë që e kanë bërë atë plan, atë plan mbashtitmi e kanë bërë specialist dhe kanë hedhur faktin. Mund të ketë edhe gabime të tjera, Nuk e them dot, por prandaj këshilli thotë rast pas rasti, kur ka një shqetësim, kur ka një dokumentacion, bën rregullimet e mundshme.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë në këtë tangencialen që sapo shtrove, unë besoj që t'i ftillojmë dhe në që kryekëshilltarët më mirë do ishte edhe me këto që po ju themi bashkarisht të dy. Problemi është nëpër komisionet të jetë prezenca e njërit prej pjesëtarëve që harton projektin. O pyjorja, o ligjorja, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kur takoni, ata janë të gatshëm. Vetëm lajmëroni orarin. Atëherë është më fal.

Yllson Ibrahimllari: Kemi thënë, e ka shpallur kryetari dhjetë me trembëdhjetë, një ditë para mbledhjes.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kemi mbledhje te komisioni, po ishte dhjetë me trembëdhjetë, po s'kish asnjë anëtar këshilli, vetëm ishte një a dy. Ja ku e ke tanin, atëherë në një orë nuk binte njeri të bëheshe mblese.

Ornildi Demollari: Ju lutem, vijojmë tani.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nëse kjo është pjesa juaj, ne jemi të gatshëm që në çdo mbledhje komisioni, në varësi të projektvendimeve që kemi hartuar, të jemi prezent unë apo drejtoritë përkatëse sipas sektorëve. Unë zakonisht kam qenë në komisionin e financës në shumicën e rasteve, pasi ka të bëjë me vlera financiare, apo kur duhet edhe nga specialistët e financës. Në çdo rast, sipas sektorëve, patjetër. Pasi ata nënshkruajnë, ne vetëm bëjmë firmën pas tyre.

Ornildi Demollari: Ju lutem, e kalojmë në votim projektvendimin për një ndryshim në ekonominë pyjore Mesmal.
Kush është dakord? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet. Faleminderit.Miratohet dhe do kërkojmë ta rishikojë zyra juridike, ta shikojë dhe të na thotë se çfarë duhet bërë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dhe diçka që të jepi korrekt, kryetar, zyra juridike ta shikojë edhe në qoftë se s'ka problem të zbardhet me ndryshimin. Në qoftë se s'ka problem të vijë të shpjegojë këshilli, pse si duhet të bëhet sekret. Unë nuk besoj se ka një problem, megjithëse për mendimin tim ajo e merr automatikisht ndryshimin. Pse harta nuk po ju them, po të nxjerrim vendimin e dy mijë e njëzet e njëshit, nuk ka as koordinata në vendim, po them. Bashkëngjitur hartave, po tani do i bashkëngjitet një hartë e re, e cila ka ardhur nga. Specialistët dhe merrni vendimin dhe ajo automatikisht e ndryshon.

Ornildi Demollari: Edhe në logjikën time, në njohuritë e mia, unë jam mendoj atë që po thotë kryetari, që vendimi i ri rrëzon vendimin e vjetër dhe s'mund të jenë të dy në fuqi. Po dakord mo dakord, ta shikojmë, ta shikojmë, ta shikojmë, ta shikojmë. Ta shikojmë në përputhje me ligjin si veprohet në këtë rast, absolutisht, absolutisht po. Atëherë ecim, ju lutem. Jemi tek materialet. Kalovi në votim, miratohet thashë, faleminderit. Edhe Luli e votovi, pastaj kërkovi fjalën, miratohet. Atëherë jemi te provendimi për rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025. Dhe jemi tek këto dy blerjet të kostumeve për artin, grupin e artit, edhe sportin. Kush e do fjalën?

Ornildi Demollari: Këto janë konsultuar me juristët? Që njëra firmoset në njëzet e një dhe na vjen një ditë para mbledhjes. Që tjetra firmoset njëzet e nëntë dhe është jashtë afateve që i paraqiten këshillit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kërkuam dakordësinë e këshillit që t'i futim në doktor, që po i futëm rendit, po i futëm tani, të cilat nuk kanë ndonjë që duan një konsultim shumë të madh dhe mund të futen në një rad të caktuar edhe brenda mbledhjes kur është. Mirësia e të gjithëve, megjithatë, unë mendoj që ju e keni futur në rini.

Faslli Zholi: E konsumuam, doktor, e konsumuam. E konsumuam, me gjithë parregullsi, e thotë gjë që jeni në kohë, që e morëm.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Njëra është vetëm ndryshim fondi, nuk ka. Është e miratuar nga këshilli, po e kemi ndryshuar nga gjashtëqind e dysh në dyqind e tridhjetë e njësh për t'u futur si material inventari.

Petrit Kupe: Edhe komisioni tha, okej, për vlerat e pakonsiderueshme.

Ornildi Demollari: Për blerjen e kostumeve sportive, e kalojmë votim.?
Kush është dakord? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet. Faleminderit.Kalojmë tek projektvendimi tjetër për veshje popullore. E kalojmë votim?
Kush është dakord? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka. Miratohet. Faleminderit.Pika tjetër është projektvendim për miratimin e transferimit në pronësi të bashkisë Maliq të sipërfaqes prej një mijë e shtatëqind e dyzet e një metra katror të llojit truall, pjesë e pasurisë numër njëqind e gjashtëmbëdhjetë, fraksion treqind e dy zona katastrale, dy mijë e katërqind e dyzet e pesë fshati Libonik, aktualisht në përgjegjësi administrimit të Ministrisë së Mbrojtjes. Edhe këtë e shtuam së fundmi, Andi duam të na shpjegosh diçka më shumë rreth kësaj, por pos çfarë ka materiali domethënë?

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Atëherë, pasuritë e mësipërme bëjnë fjalë për njësinë administrative, objektin e njësisë administrative libonik, së bashku me truallin që okupon ajo. Pasi rreth e rrotull njësisë administrative, rreth e rrotull kësaj prona janë disa prona që janë dhënë me vendime komisioni. Si dhe një pjesë e konsiderueshme ka qenë pjesë e ish-brigadës të lehtë të këmbësorisë. Dhe nga korrespondencat që ne kemi kryer me Ministrinë e Mbrojtjes, ata kanë pranuar që pjesën të cilën okupon njësia administrative të na i kalojnë. O në pronësi, o në përgjegjësi administrimi, në mënyrë që ta heqin nga inventaret e tyre. Duke qenë që nuk përmban ndonjë problematikë, sepse për ne na shtohet një pasuri, të cilën e kemi në administrim, e kalojmë vendpronësi. Ja kemi paraqitur edhe këshillit. për të dhënë miratimin e vet në mënyrë që ne të vazhdojmë me procedurat e nxjerrjes të VKM-së dhe kalimin e saj në

Ornildi Demollari: Nga Ministria e Mbrojtjes kalon në pronësi të Bashkisë Maliq, po konkretisht Ministria Administrative e Libonik?

Faslli Zholi: Unë duhet të shtoj diçka këtu, e kam parasysh atë objektin që është edhe, të gjithë e dimë, që është njësia administrative. Edhe e di se si ka qenë edhe reparti, po ka një gjë aty, Andi, se ne do ta marrim vërtetë. E ke parë atë familjen që është mbrapa, janë familjet dhe i ka ardhur avllia me i llaf ndanë me murin e godinës. Kështu që ajo është e uzurpuar atje, ajo godina na mbrapa duhet ta dijë edhe çupa, dhe tërë e di. Ajo është e uzurpuar. Është e uzurpuar që ajo

duhet të linte pjesë, bile ajo familje ka sjellë, jo se e kam unë atë vëllain që kam të sëmurë atje, po sjell dhe telashën. Ajo duhet të lirohet atje. Në qoftë se ashtu do të shikoni edhe me ministrinë e mbrojtjes, sepse unë i di ku ata, se bile ata që janë mbrapa, autorizimet ia kam dhënë unë. Me dikë dhe i di mirë si është, ajo e ka bërë, po e keni parë dhe murin dhe rrugën, bllokon dhe ata familjarët e tjerë që janë atje. Duhet parë kjo punë, meqë ashtu e sugjerova këtu që ta keni dijeni se disa herë ka vajtur edhe policia bashkiake për këtë histori. Që është një ngatërresë, vajti të bënte dhe pus bëjnë si duan. Ajo ka qenë pronë ushtarake shumë mirë, bën që e bashkia ta marrë është se komuna, por të jetë në bazë të piketave dhe mbasë ligjit dhe skicës që ka, po ta shikosh mbrapa, kushdo dhe ashtu nuk ka rrugëdalje tjetër. Le të dalim mbrapa administratorja ta shikojë, se shtëpia apo godina do t'i dalë sot edhe mbrapa. Ajo e ka uzurpuar, kështu që këtu duhet patur kujdes që kur të hash në udhëheqësin. Tolirohet ajo përmendimin tim, sepse është e zhdukuar dhe është e padokumentuar. Nga ata zotërinjtë, është e pa dokumentuar dhe do e kini mollë sherri me ata familjarë, po qoftë edhe me njësia që do të jetë aty. Sepse do i dalësh nga mbrapa godinës, do ta, do ta suvatosh, do bësh një riparim. Nuk të le, sepse e ka ngjitur, e keni parë si e ka kthyer dhe. Bile, bleu dhe atë truallin prej një shpi atje, gjoja sepse i di të gjitha atje. Po ka një problem që duhet, e thashë këtë që keni parasysh. Faleminderit.

Petrit Kupe:Bëhet fjalë për një pronë që unë e njoh, po për drejtësi administrative. Por nuk jam i qartë, bëhet fjalë vetëm për pjesën e njësisë administrative që është e rrethuar, apo bëhet fjalë edhe për banesat që janë mbrapa njësisë administrative. Këtë do të ma sqarosh,

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula:jo vetëm për njësinë administrative, me gjithë vendin që okupon.

Petrit Kupe: Dakord, por unë jam dakord me fjalën e parafolësit. Mbrapa njësisë administrative janë disa banesa, një banesë që është në krye të atyre magazinave të ushtrisë, e ka zënë gjithë territorin dhe në një krah të njësisë administrative dhe mbrapa njësisë administrative, asnjë nuk ka të drejtë të bëjë me remetimin e çatisë. Dhe kjo familje ka sjellë probleme edhe me familjet më parë, kështu që duhet parë. Që vërtetë merret kjo si pronë, por edhe njësisë administrative t'i lihet territorit që i cakton me ligj, distanca që duhet mbrapa ndërtesës, jo rrafsh me murin. Sepse atje unë kam ndërtuar një garazh dhe e kam prishur atë rrethim dhe kam plasur luftë me atë. Unë kam shkuar në polici me atë që ka zënë atë. Po në të njëjtën kohë ai ka edhe në krahë të djathtë të ngjitur me njësinë administrative, ka ndërtuar një garazh. Domethënë, njësinë administrative ai e ka lënë vetëm përpara. Aty duhet respektuar, unë jam dakord të merret dhe nuk bëj ndodha, se atij i fikon tërë shtëpia rrugën.Ai ka sjellë probleme edhe me familjen që është më poshtë, nuk i le rrugën. Bile, do ta dini, a ju ka vënë dhe një bombë atje? Ka plasur sherresh.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të ju shpjegoj kjo vendimarrje që marrim sot. Është në hallkat apo në një moment që do t'i jap zgjidhje gjithë problematikave të pronave që janë aty. Se nuk kemi sot një çertifikatë dhe një planvendosje dhe një skicë nga kadastra. Që të vemi me një titull pronësie, të themi të lutem ke afat, dy ditë, tre ditë, liro territorin që s'është sendi, po

është. Në këtë hap është edhe kjo që po bëjmë. Biles, për të qënë të sinqertë, jemi ne të vonuar të një dokumenti që ka kohë që ka ardhur dhe ka mbetur i pa. I paalokuar nga ana jonë.

Faslli Zholi: Shkurt e thashë këtu, kryetar, do ta marrim ndërtesën, po ta merrni me parametrat që i takon ligji. Do ta marri bashkia ndërtesën, ta merrni me parametrat, jo të jetë e zotëruar nga diku ligji.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Shqetësimi juaj është plotësisht i drejtë. Ne i kemi patur parasysh të gjitha këto. Ju sapo përmendët dhe një ndër arsyet që ne ju futëm kësaj pune është thjeshtë për të për të bërë qetësimin dhe uljen e tensioneve që janë. krijuar në atë zonë për këto ndërtime pa kriter. Dhe në kuadrin e lirimit të hapësirave publike dhe me mbështetjen e kryetarit u bë kjo korrespondencë e dytë, ndërkohë që dytë. Përsa i përket sipërfaqes prej një mijë e shtatëqind e dyzet e një metra, kryetari sapo e tha që është një sipërfaqe e përcaktuar dhe e kaluar para disa kohësh, e cila gabimisht, nuk mund ta them, duhet të ishte bërë më përpara e regjistrueshme. Gjithsesi, më mire vonë se sa kur thotë populli, ne këtë dokumentacion e kemi marrë, kemi bërë një korrespondencë të dytë. Me ta kaluar në pronësinë tonë, punën e parë që do bëjmë, ajo është.

Petrit Kupe: Jo, jo, unë nuk jam dakord. Kjo sipërfaqe nuk e përfshin pjesën mbrapa. Në qoftë se ne e marrim këtë vendim, do të duhen vendime të tjera që t'ia marrim atij. Kjo sipërfaqe të shtohet, të korrigjohet atje ku është zaptuar. Edhe ti ik ai.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula:Më fal, të bëj edhe një sqarim tjetër.Pa dashur të replikoj. Situata është që në dy mijë e njëzet e treshin, sipërfaqja e miratuar. nga komanda mbështetëse dhe nga ministria e mbrojtjes është kjo dhe sipërfaqja e përcaktuar nga ata nuk se u propozua nga ne. Më kupton, është një sipërfaqe e gjetur dhe e dërguar për kalim pronësie që në dy mijë e njëzet e treshin. Meqënëse kryetari e tha, ne nuk po bëjmë një të re.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ajo çfarë këshilli edhe unë kërkoj. Është duam një plan rilevimi të asaj pasurie me godinë me pronë, si është dhe si figurojnë pronarët e tjerë me ne. Po, kaq është e thjeshtë., duhet një plan lirlevimi i godinës sonë dhe çfarë ka territor.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Po pra, atë kemi bërë kryetar. Por kjo ka qenë e bazuar në atë çfarë na kanë dhënë ata.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do ta shikojmë se duke nxjerrë një titull pronësie për bashkinë. Do kërkojmë dhe dokumenta për të tjerët dhe patjetër do të shkojmë atje. Një tokë, o është tona, o është e shtetit, edhe është ose jo, do të zgjidhet nga ana jonë patjetër.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula:Është fiks, siç po thotë. Është fiks, siç thotë kryetari.

Ornildi Demollari: Atëherë kalojmë votim, ju lutem?
Kush është dakord? 14 vota pro.
Kundër? 5 kundra
Abstenim.Nuk ka. Edhe një herë mbajni kartonat që t'i numërojmë, ju lutem, kush është dakod? Tre, gjashtë, nëntë, dymbëdhjetë, katërmbëdhjetë dhe pesë kundër nuk miratohet, ose mos gaboj. Me shumicë të thjeshtë, po po, miratohet, miratohet. Me katërmbëdhjetë pro dhe pesë kundër, miratohet. Faleminderit, më falni mua. Ecim, nuk kemi çfarë bëjmë më, me katërmbëdhjetë vota pro miratohet. Kalojmë, kalojmë, kalojmë tek pika tjetër, kalojmë tek pika tjetër e rendit të tjetër, o Andi u miratua.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Ne e kemi marrë gjithë dokumentacionin të qartë na ka dhënë Ministria. S'është se po ia propozojmë sot, edhe pse i bëhet një mijë e njëqind, bëheni një mijë e pesëqind.

Petrit Kupe:Më kupton, ne jemi çfarë na kanë dhënë, po ti i ngelet fuqish ajo që po jep sot, dhe ai tjetër mbrapa nuk e prish dot. Po kujt ta kërkojmë ndryshimin? Jemi edhe për pjesën mbrapa. Sepse ky i ka dhënë objektin, tullat i ka dhënë atje, nuk i ka dhënë atje.Ti po e bëre të ligjshme sot, po e bëre të ligjshme sot.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Po, pikërisht pra, duke kërkuar dokumentacionin e të tjerëve, po u bëre pronar vetë, do kërkosh dokumentacionin e atyre që ke rreth rrotull.

Faslli Zholi: Nuk duhet ta shikoni se shteti, meqë po hyn bashkia, tamam bëhet shumë keq që ta marrë e të jetë dhe ta gëzojë. Dhe është një vend shumë i përshtatshëm për çdo gjë, e shfrytëzon në nesër të këtij ndjen, por tjetër.

Ornildi Demollari: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës. Është informacioni, analiza e zbatimit të buxhetit të bashkisë Maliq për tetë mujorin e vitit dy mijë e njëzet e pesë. Kryetar ke fjalën.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ju kemi sjellë një analizë financiare tetë mujore. Në fakt, duhet ta kishim sjellë që gjashtë mujore si një detyrim ligjor që e ka bashkia. Kemi dhënë një informacion mbi situatën e të ardhurave të realizuar në masën 45%, situatën e realizimit të shpenzimeve në masën 57.6%. Ka disa informacione për efekt të investimeve të realizuara dhe të likuiduara. Atë çfarë duhet të bëjmë me dije këshillin është edhe një informacion. Ndoshta dhe mund t'ia kishin vënë në dispozicion të investimeve të realizuara gjatë vitit 2025. Kemi realizuar deri tani 21 objekte nga të cilat. Kapin një vlerë dyqind e tetëdhjetë e dy mijë nëntëqind e pesëdhjetë mijë lekë të reja në vlerë limit. Të prokuruara me një vlerë njëqind e nëntëdhjetë shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë lekë, apo me një ulje rreth tridhjetë e tre për qind në totalin e përgjithshëm, që do të thotë që i kemi kursyer bashkisë me procedura. Prokurimi rreth tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë milionë lekë të reja, domethënë. Një punë shumë e rëndësishme, doja ta

citoja këtë, se është një punë shumë e rëndësishme që bashkia bën për efekt të efektivitetit të fondeve buxhetore. Mund t'ju citoj atë çfarë ne kemi realizuar gjatë deri në këtë periudhë. Jemi duke finalizuar një tarracë solare me financim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me një vlerë 9.3 milionë lekë. Sistemim asfaltim rrugë, viti dy mijë e njëzet e pesë, me një vlerë katërmbëdhjetë pikë nëntë milionë lekë. Tërësi korsi biçikletash me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, rruga që shkon në drejtim të Drithasit, ku bashkia ka mbuluar pjesën e punës dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Na ka financuar me materialet dhe aty tashmë ajo është drejt finalizimit me ndonjë gjë të vogël. Kemi zbatuar një objekt për rikonstruksion, objekte ndërtimore, sistemim asfaltim. Rrugë dy mijë e njëzet e pesë blerje mini-fadrom me ambasadën japoneze, sapo e kemi finalizuar blerjen e mini-fadromit bo kati të ri me tre pajisje. Kemi mbyllur një fazë të parë për terrenin sportiv në Bregas. Shërbim mirëmbajtje mjete janë gjërat. Thjeshta rehabilitim objekte terrenesh shkollore jemi në zbatim e sipër, po ndërhyjmë në shkollën e pirgut, po ndërhyjmë në qendrën shëndetësore të burimasit. Betonim rrugë Gorë Moglicë, edhe këtë të realizuar rrjeti i brendshëm i ujësjellësit të Moglicës, i financuar, i realizuar. Presim që ujësjellësi Korçë të vendosë macat, pasi e kanë kërkuar dhe ata vetë që të kenë ujë pa ndërprerje. Kemi zbatuar një projekt për kanalizime të ujëra të zeza në disa zona problematike. Kemi mbyllur sistemim asfaltim në fazën e parë të rrugës Kolanecit. Jemi duke, jemi në fazën për të ndërhyrë në dy rrugë në Zvezdë. Kemi mbyllur blerjen ndriçues rrugor dhe jemi duke bërë. Reparimet e mundshme në territor, pasi ka ndriçues të djegur, rigonstruksion objekte ndërtimore, faze e dytë. Edhe këtë e kemi realizuar, kemi bërë një blerje të një borë pastruese me fondet e emergjencave civile. Kemi rehabilituar objekte infrastrukturore vitit 2025 për tre objekte me fondet tona. Përmirësimi i banesave sociale sa kemi filluar me një fond, me një projekt të fituar me Ministrinë e Ekonomisë për rehabilitimin e 39 godinave. Janë rehabilituar katër të parat në Podgoricë dhe do të ecim në fshatrat e tjerë. Kemi disa objekte të pambyllura, se është Semim Sheshi Qendra Komunitare Maliq. Sistemim asfaltim rrugë, fazë e dytë, blerje kentë lojrash për fëmijët, edhe blerje material gazi për shkollat apo për institucionet. Këto janë investimet, të cilat janë realizuar deri në këtë periudhë. Dhe e rëndësishme është që me fondet që ne kemi kursyer, atë fond që thashë rreth tetëqind e gjashtëdhjetë milionë lekë, i realokojmë për t'i përdorur përsëri në objekte të cilat. Zona jonë ka nevojë rrugë nga të katër anët apo në objekte të cilat janë miratuar prej jush, por në faza të dyta për objekte të cilat janë. Janë futur në prioritetet tona të të bashkisë materialin. Në qoftë se kemi ndonjë pyetje pastaj për efekt të asaj çfarë kemi arritur deri tani, edhe për ne është ende shqetësim realizimi i të ardhurave, i cili është në nivele jo të kënaqshme, pavarësisht. Që ne bëjmë një buxhet të ardhurash pa rezervë, me idenë që të kemi mundësi që edhe të programojmë fonde për efekt të investime, se po mos e programuam, nuk i hedhim dot. Dhe kjo jemi midis dy zjarresh të themi, fonde që duhet t'i planifikojmë pa rezervë, bashkë me debitorët. Dhe investime që duhet t'i realizojmë, që të kemi mundësi jo vetëm një fazë, po dhe faza të tjera për efekt. deklarimin thesar dhe për efekt shpallje të prokurimeve publike të investimeve në të gjithë bashkinë. Në qoftë se ka pyetje konkrete. Në lidhje me material apo dhe me gjëra të tjera që kanë të bëjnë me funksionimin financiar të bashkisë, unë jam i gatshëm t'ju dëgjoj ose në qoftë se duhet ndonjë gjë specifike mund të kërkojmë nga drejtoria e financës.

Petrti Kupe:Në këtë material që kam parë parasysh ato që tha kryetari, që është një punë e mendimit tim e pëlqyeshme. Më bie në sy një tregues, drejtoria e shërbimeve paga sigurimi shoqëror realizon rreth gjashtë për qind, shpenzimet operative njëzet për qind. Kryetari i di shpjegimet, po edhe unë mendoj që janë disa arsye që ndoshta agjensia u krye edhe me vonesë. Ndoshta edhe stafi ishte ishte një agjensi e krijuar rishtas dhe stafi ndoshta edhe stafi i pa ingranuar në atë, por që kjo ndikon se të punosh me njëzet përqind të shpenzimeve për aty vetëm sot. Të punosh në shërbime dhe mungesë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nëse tashmë kanë filluar, janë realizuar pavarësisht se do ta realizojë deri në fund. Se punë prokurimesh janë ato dhe duan edhe ato.

Petrti Kupe: Tjetër që kisha për të thënë, desha të vlerësoja. Një punë e mirë që u bë nga kryetari, duke bashkuar edhe me këshilltarët për rrugën drithas poshtë Liponik. Është një rrugë me standarde. Kjo rrugë dhe rruga Maliqi-Libonik, besoj se janë rrugët më të mira të ndërtuara në këto vite me standarde. Që kanë të gjithë treguesit, biçikleta, ndriçimi, gjelbërimi dhe të tjera. Këtu është një punë që bie në sy, ndoshta në territorin tërë territorin e bashkisë Maliqit. Kjo është puna më e bukur që është bërë. Përveç kësaj, desha të thosha pse kanë ngelur punimet për fushën e sportit, Drithas, ndoshta. Edhe kam një merak, ajo rrugë përmendimi i tij kryesor duhet vlerësuar. Është një nga fshatrat më të mirë, më turistik, më të këto kisha.

Ornildi Demollari: Po, Idlir.

Ildir Limllari:Përshëndetje, kryetar kisha një jo vërejtje, po edhe vërejtje mund ta marrësh. Këto shkollat më duket si të hanë pas dore, asnjë kompjuter, asnjë, asnjë shërbim në kuptimin e laboratoreve, po edhe fëmijët po shkojnë me dru, nuk po shkojnë me libra. S'ka ngrohje, faleminderit.

Ornildi Demollari: Po Luli,

Lulëzim Hoxhaj: Nuk ka ndonjë gjë për këto që u trajtohet edhe kryetari, por të. Ja, edhe dy minuta, po në fund, s'ka gjë. Në dijeninë time kam një informacion që në muajin janar do të ketë. Investime shumë të rëndësishme nga Ministria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Energjencave. Që do t'iu jepen fonde, që iu jepen bashkive për prokurim, për problemet e ato të tyre. Në këtë kontekst, dua të them që të. Atje është një konkurim, konkurim projektesh, idesh, edhe argumentash. Kryetari më kupton, e di, mendoj që ato projekte që janë për kanale të evaditjes, për këtë jepen sidomos këto. Dhe të rezervuar duhet të jenë projekte shumë serioze. Mbase duhen rishikuar dhe një herë duhen bërë, sepse ka shumë kërkesa, edhe ka pak. Ashtu bëhet fjalë, e kam sigurt këtë. Ministria e Bujqësisë rreth pesëmbëdhjetë milionë dollarë për bashkitë. Dhe po të njëjtën çmime dhe të njëjtën vlerë, edhe drejtoria e përgjithshme e emergjencave. Por dhe konkurimi, konkurimi i idesh, argumentash, projektesh dhe në këtë kontekst, që ndoshta mund të ketë nevojë ose mund të ashtu ndonjë për të risjellë vëmendjen.

Përmirësimi i ndonjë projekti në një argument të tërë.Nëse këshilli ka miratuar dhe miratuar fondet për projektimin?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kemi një projekt që sapo e mbyllim, ka të bëjë me vaditjen me pika dhe me ushqysen Leminoit, i cili bën këta vaditje me përmbytje të pafajshëm. Hape pak mikrofonin. Këtë e ka kërkuar vetë Ministria e Bujqësisë. Na ka bërë një propozim që do një projekt pilot për ta bërë në territorin e Bashkisë Malik dhe ne kemi propozuar që rezervuari i Leminotit të kalojë në një. Fazë tjetër të projekteve pilot me vaditje me pika, çdo fermer të ketë sahatin dhe sarajqineskën në krye të parcelës. Me kosto të ulët, patjetër s'ka të bëjë me investimin, se nuk duam të trembim këtu. Fermerët, por ai ta kursejë atë ujin e atij rezervuari. Po të shtojmë këtu dhe dy ushqyes që do të bëjmë. Që jemi duke hartuar projektin ushqyesin e Leminotit dhe ushqyesin e Leminotit. Të njëjtën kohë kemi një projekt për digën e. E rezervuarit të Kolanecit, edhe i cili ai është pavarësisht se ndonjëherë instancat e shikojnë, duan të vendosin aparatura. Ne duam të bëjmë rehabilitim. Digash e tjera, kjo është punë vizioni. Pastaj, po megjithatë, ne do të konkurrojmë denjësisht. Kemi edhe projekte të tjera për betonim kanalesh e tjera, po këto janë ato më kryesoret. Jemi të gatshëm të konkurrojmë dhe unë them se jemi ndoshta edhe nga më të mirët në lidhje me projektet që prezantojmë. Në lidhje me atë çfarë ngriti Liri dhe Psozhesht, unë do të sqaroj që bashkia mbulon pjesën e riparimit të shkollave të mirëmbajtjes së tyre, të lëndës drusore etjera, për të cilat, edhe pse. Është si afat ligjor të themi pesëmbëdhjetë nëntori. Ne kemi filluar të plotësojmë gjithë kopshtet dhe midis tyre edhe plasën. Kemi mbyllur furnizimin me dru zjarri të Gorës të Moglicës. Tani kemi filluar në pjesën e fushës për kopset e fëmijëve. Edhe pse data nuk ka kaluar, dhe patjetër data pesëmbëdhjetë do të jetë e kompletuar të gjithë objektet arsimore, edhe ato që do të ngrohen pastaj me pelete me naftë edhe me. Me ngrohje qëndrore, edhe ato janë në gatishmëri në lidhje me laboratorë dhe kompjuterë. Zakonisht, jo zakonisht, po ato i mbyll Ministria e E arsimit me laboratorë, me të tjera, nuk jemi ekspertë të asaj fushe, megjithëse ne çdo fillim viti apo fund viti me fonde që na teprojnë nga arsimi. Në varësi edhe të rekordimit që bëjmë herë pas here me zyrën arsimore, blejmë disa kompjuterë fotokopje për shkollat më të mëdha që ato t'i kenë në dispozicion në punën e tyre për rrugën e Kolanecit. Ne kemi financuar aty fazën e parë dhe është bërë një investim shumë i mirë, por vetë investimi është shumë i madh për ta financuar me fondet tona. Shumë qejf do të kishim direkt, por në qoftë se do të bëjmë një rrugë. Do të bjerë që s'do të bëjmë rrugë në vende të tjera, ndaj edhe e bëjmë me faza. Po mendojmë që një fazë tjetër ta realizojmë edhe në vitin dy mijë e njëzetë e gjashtë. Por në të njëjtën kohë po kërkojmë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, siç ka qenë financuesi i asaj rruge në fazën e parë, të financojmë dy rrugë dhe mund të jetë rruga e Strelcës, edhe rruga e E kolanecit. Dakord, që ato t'i mbyllim si dy zona, të cilat dhe pastaj të shikojmë te zonat tjera, të cilat në të njëjtën kohë një nga prioritetet tona janë rrugët e bardha. Për të cilët mendojmë të futim rrugën e Mesmalit edhe rrugën e Berasit, si dy nga zonat që duam edhe ato t'u japim një impakt në rrugë të bardha, që bëhen tombino kanalizime me çakë dhe me të tjera. Një risi që mendojmë ta financojmë në dy mijë e njëzet e gjashtë. Faleminderit, besoj në përgjigje.

Faslli Zholi: Jo dy gjëra, se i ngrita dhe radhën e parë. Përsa i përket punëve që janë bërë në infrastrukturë, unë për veten time të përgëzoj dhe të falenderoj, sa e tha dhe Petriti, rrugën e

dritësit u bë shumë e mira. Edhe ke filluar edhe sportin, ato janë. Punët e tua dhe ke qenë në operativ dhe për këtë unë i di. Dua të shtoj një diçka, meqë jemi këtu aty në kryqëzimin. E kam ngritur edhe një herë problemin. Ai kryqëzimi duke më bë. Të biseduar me autoritetin rrugor, a si mund ta zgjidhni me ndonjë semafor? Se ka tashti gjëra, kam thënë edhe një herë dikur. Se është një problem dhe një burim vdekje njerëzish. Dhe një ditë dhe aty u bë një skandal. Ishte zonja me gjithë fëmijë, mos gabohem, me këtyre zhytreve u bë përplasje. A është një vend? Dhe a mund të mendohet një diçka, një mbikalim këmbësorësh? Sa është keq edhe ai krizimi e para. Së dyti, dua të them për rrugën e varreve të Libonikut. Nuk është ndonjë gjatësi e madhe, kushedi se dikush kur bisedojnë aty me ne birin e tha, tha të bëjmë një jetë të gjallë. Po unë mendoj se një ditë të shkojmë të gjithë atje. Ajo nuk është rruga e gjatë, po dhe një çësëm ujë atje që nuk ka fare. Mirë ishte të ishte ajo kurdo që erdhën këtu, po të kishte qëndruar. Që duhet parë kjo punë, sepse unë e dëgjoj edhe një herë për videot, një herë u bë kështu. Ne e kemi ngritur, po TV, meqë jemi në këto projekte. Këtë bëhet dhe kjo rrugë e varret Libonikut është imediate, mendoj unë, dhe është baltë. Ke mall të vesh tek një i dashur që është i varrosur. Tjetër gjë që kam aty në rrugën time, ju hyni koshien për këtë, se paskeni qenë ma tha dhe ajo zonja, unë e kam edhe në video këtu. Kanali i madh i urave të zeza, që vjen që nga drita, se kalon në rrugën e shtëpisë, ato në të tëra lagja, shkon dhe përplaset nga ajo lagja, që nuk do t'i prevezojë se janë të zeza me ngjyra veshë. Është një problem i madh dhe unë kur vajta që ra shiu, ujërat e zeza më falni ishin të tëra në ajo familja, pavarësisht se është si është. Dritan Kanani quhet, ju e keni parë, dhe më thotë ngrihet si problem me shqetësi. Dhe pjesa pullat tona e rrugës që kemi kërkuar ato dy tuba, ato pullat që janë prishur, bile ndërhyjnë ata dhe prapë se kanë riparuar dhe e kanë lënë. Kjo është neglizhencë edhe e atyre. E hapën rrugën siç e çave ato pullat. Prapë rrihet atje se i bëjnë punë në shkollën e shkollës, s'kanë ardhur më. Ia kam thënë dhe atij përgjegjësit që është shumë djalë i mirë për mua. Dhe i dërgon njerëzit të mirë, por njerëzit nuk e bëjnë ashtu, nuk është përgjegjësia jote. Po duhet kërkuar kjo që ajo të mbyllet ca, sepse qe rrugë e mirë dhe është absorbuar. Dhe mbushet me plehra. Unë kam kërkuar tuba që mos mbushet me plehra e pjesa që është. Dhe është bllokuar, është problem. Tjetër kisha dhe një diçka që më kanë ardhur. Disa nga ana tjetër sot do sillen edhe kërkesën me pesëmbëdhjetë. Është një pallat këtu tek kryeplaku i lartë, nuk e di me saktësi. Janë pesëmbëdhjetë familja Pikol. Meqënëse jeni në kuadrin e këtyre rregullimeve të çative, qoftë se është e domosdoshme e pallatit të mos bjeri, sepse janë njerëzit brenda, shikoheni. Ma kanë thënë ata djemtë që ngrihen në këshillë, do bëjmë edhe dokumentin e kishin bërë, më thanë edhe me firma që ta sillja këtu. Gjithsesi, unë po e diskutoj dhe kam besim se ti ndjekësh këto punë dhe që të bëhen mos mos i ngrejmë herë pas here.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Faleminderit. Kjo, të cilën po diskutojmë tani, i bie që është problematika që kanë të bëjnë me buxhetin e vitit 2026 që vijnë. Pavarësisht këtë të pallatit, ne po e shikojmë dhe e dimë si rast kemi dhe zona të tjera. Kemi marrë një nisëm për zgjedhjen e administratorëve të pallateve. Pasi edhe kjo nuk mund të ecë kështu përmbarimisht, që asnjëri nuk kontribuon tek banesat që janë banesa kolektive të atyre banorëve. Ne jemi shumë dakord që të mbështesim, bile duam të hapim një risi, që ata banorë të cilët paguajnë diçka. Mbledhin një kontribut që edhe e mbrojnë dhe më shumë pallatin e tyre. Ne jemi të gatshëm ta bashkëfinancojmë bashkë me ta dhe të bëhemi. Edhe zbatues të një projekti të përbashkët dhe po

e shikojmë edhe atë pallat dhe pallate të tjera apo shtëpi, të cilat ndonjëherë janë. Të lëna në mëshirë të fatit, pasi një familje mund të jetë larguar, dy të tjerët nuk ndërtojnë. Edhe vërtetë shumë problem lidhur me investimet e tjera, edhe me rrugën e varreve, edhe me atë kolektorin e ujërave të zeza. Janë planifikime që ne mendojmë për t'i realizuar në vitin 2026, sipas një prioriteti, por nuk mund të flasim sot, që ende nuk dimë sa do të vijë Grandi. Sado jetë buxhet i pavarur, sado janë detyrimet tona të këtij viti, etjera, etjera. Kështu që në momentin që do të prezantojmë tek ju buxhetin e vitit të ardhshëm. Patjetër do të japim edhe një pasqyrë të asaj çfarë mendojmë të realizojmë në vitin që vjen. Nuk e dija t'i thashë të gjitha, po besoj po.

Petrit Kupe: Dhe unë diçka, Aty në komision u bisedua edhe për dy probleme të tjera që nuk kishim dhënë me financën. për një aktivitet në kuadrin e programit të Këshillit të Bashkisë në fund të muajit. U dha dhe ideja kështu që mendoni që në fund të muajit këshilltarët marrin pjesë. Edhe një tjetër që kisha,Kryetari i dha një porosi, dha një porosi.Kjo do të ndiqet nga sekretari i këshillit, hartimi i projektit, preventivit, etjera. Dha një porosi për ekzekutimin e vendimeve të atyre titujve të dhënë, titujve të nderit të dhënë, i cili është momenti që zakonisht në kuadër të festave. Duhet të ekzekutohem, po ajo do të organizohet si të organizohet, kështu që edhe kjo do të kryhet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jemi të gatshëm patjetër për të mbyllur dhe pjesën e dhënies të titujve dhe letër akordohet me sektorin e kulturës, që ato të bëhen. Edhe në takime, të cilat edhe për t'i vlerësuar, jemi në fund të vitit dhe besoj do të ketë aktivitet disa lloje. Kështu që sekretari i këshillit, sektori i kulturës, duhet të rekordojnë,për efekt të dhënies së titujve që kemi dhënë gjatë gjithë periudhës së fundit. Nga ana tjetër, për atë çfarë u fol në lidhje me trajnimin e këshilltarëve apo me lëvizjet e tyre nëpër Këshilla si motra, këtë duhet të ndiqni patjetër procedurën ligjore, të vijë një propozim konkret. Të jetë një ftesë ku do të shkoni, se do të shkoni, dhe patjetër duhet të rekorduar me financën. Që çdo gjë të jetë brenda kuadrit ligjor të përcaktuar.

Ornildi Demollari: Atëherë, tek diskutimet e ndryshme kemi letrën e një zotërie që është këtu në sallë dhe po ia lexoj tani. Është një kërkesë. Kërkesë drejtuar këshillit, zoti Reis, në respekt të institucionit. Në respekt, në respekt të institucionit, ore ju lutem unë. Ju lutem unë.

Yllson Ibrahimllari: Në respekt të institucionit, para se ta lexosh letrën e Reizit, se po bëhen gjithë për të dalë. Kryetar, mbasi mbaroi kjo. Matura shtatëdhjetë me këto aktivitetet për trajnim të këshillit. Meqë ne jemi bashkia në nivelin më të lartë bujqësor, besoj nga më të lartat edhe blegtoral. A mund të na informoni për paketën e maleve nga takimi që kishit me kryeministrin? Se kjo ka më shumë vlerë sesa vallëzimi i lulit edhe i verës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po mund t'ju jepja një informacion, ndoshta edhe me shkrim, që ju ta kishit, megjithëse telegrafisht do t'ju them që deri në këtë, deri para dy ditësh. Ka patur gjashtëdhjetë e tetë kërkesa apo të interesuar që kanë aplikuar në portalin e paketës maleve. Ne kemi mbyllur Hartëzimin themi dhe përcaktimin e zonave prioritare me zhvillim dhe jemi

munduar të përfshijmë gjithë pjesën malore të bashkisë Maliq. Një zonë kemi përfshirë nga Maliqi Gorë-Moglicë, një zonë PirG-Podgorie deri në... deri në Plasë gjithë pjesën malore dhe një zonë, pjesën malore të Libonikut, pjesën malore të Maliqit, tre zona dhe i kemi. Jemi të hapur t'ia tregojmë në një moment më të parë tre hartat e përcaktuara. Kemi përcaktuar harta me sipërfaqe me koordinata. Harta të cilat, po të klikosh në çdo pikë të territorit të bashkisë, të jep koordinatat edhe të jep. Në një farë mënyre, se ajo do të akordohet, por ky është hapi i parë për të cilën përcakton edhe të interesuarin edhe pronën është pronë shtet, është pronë me pronar, është pronë e ndarë, etjera shumë elementë. Megjithatë, kjo le të jetë se portali është ende i hapur. Dhe mund të aplikojë çdo i interesuar që posedon një pronë, të cilën në një farë mënyre e ka të familjes vetë, por i mungon dokumentacioni për një arsye ose një tjetër. Dhe të ndiqen gjithë procedurat, patjetër do të vijë në këshillën e bashkisë në momentin e fundit, kur ato të marrin okej, do të shpallen rreth dyzet e pesë ditë në të gjithë territorin e bashkisë, sipas njësive administrative, për të parë a ka kontradita, a ka ankesa, a ka dhe pastaj do të merret vendimarrja. Të shpresojmë që. Pse mos fitojnë të gjashtëdhjetë e tetë apo pse mos shtohen të tjerët që zonat tona malore të zhvillohen, të kenë impakt dhe patjetër ne do të na kenë në mbështetje. Për t'i dhënë një zhvillim zonave tona, ky le të jetë një apel. E falendoj doktorin që e bëri, që më ngacmovi për këtë pjesë. Le të jetë një apel për të gjithë ata që mendojnë që mund të përfshihen në këtë paketë.

Yllson Ibrahimllari: Them së pari, cili është afati përfundimtar i aplikimit? Ku gjenden këto dokumenta në faqen e këshillit, në faqen e bashkisë? Ku janë të publikuara? Dhe si mund të aplikojnë qytetarë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Portali është publik. Mund të hysh në portalin paketa e maleve, kushdo mund të paraqitet në zyrën tonë të në hollin tonë të informacionit, po dhe në çdo njësi administrative. Çdo punonjësi jonë e di mund t'ju ndihmojë. Dhe aty kërkojnë disa të dhëna për të cilën thotë çfarë pronë ke e posedon sa vjet ke. Nuk i di. imtësisht ç'a kërkon, por kanë ca dhëna që i evidentohesh aty, derisa gjashtëdhjetë e tetë deri tani kanë aplikuar. Kanë hyrë në pjesën e portalit dhe ne i kemi çuar në kryeministri, në Ministrinë e Pushtetit Vendor, për t'u marrë vendimarrja për zonat përkatëse. Por kjo s'do thotë që, pse e çuam ne, nuk aplikimet vazhdojnë. Dhe në moment të dytë do ketë një portal të dytë ku kërkohet plani i biznesit, ku kërkohen të dhëna të tjera të cilat të orientohen aty se çfarë duhet bërë.

Ornildi Demollari: Në respekt të institucionit, me besimin se nuk do qëndroni indiferent për të më mbështetur. për të denoncuar krimet e rënda që janë bërë në fshatin Strelcë, por edhe më gjerë në shkatërrimin e mjedisit. në përgjithësi e vazhdimësi, duke qenë i vendosur bazuar në vullnetin e pashtershëm për të përballuar të vërtetën. Me mashtrimin i vendosur në pozicionin e durimit, se e vërteta, edhe se vonon, nuk harron. Bazuar në kohën që më jep të drejtën për të filluar hetimet. Reflektimet e këshilltarëve të Bashkisë Maliq. Disponoj dokumenta deri edhe shkencore për të përballuar me realitetin, përpara drejtësisë. Sot, më datën 26 gusht 2024, kjo kërkesa ka erdhën datën 26.

Qytetari: Në gusht të dy mijë e njëzet e katërt, po ju them këtë, që them për paketin e malit.

Ornildi Demollari: Tani për letrën të lutem, po për letrën tani, po për letrën tani.

Qytetari:Që të bëhet paketa e maleve, duhet t'u thuash fshatarëve. Më zu ai mua ta shihni sërish, kush i ka marrë paketat e malit atje? Kush ka aplikuar?

Ornildi Demollari: Ju faleminderit, kjo ishte mbldhja për sot, ditë të mbarë.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA MALIQ